

C) PROPOZIMI

PËRMBAJTJA

Lista e figurave, hartave dhe tabelave

1.0 SKENARËT E ZHVILLIMIT

1.1 VLERËSIMI I SKENARËVE

2.0 PLANI RREGULLUES – ELEMENTE TË PËRGJITHSHME

2.1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

2.1.1 Emri i planit

2.1.2 Baza ligjore për planin

2.1.3 Elementet identifikuese të planit

2.2 KORNIZA E ZHVILLIMIT

2.2.1 Synimet e zhvillimit

2.2.2 Koncepti

2.3 KËRKESAT E PËRGJITHSHME

2.3.1 Popullsia dhe banimi

2.3.2 Institucionet

2.3.3 Përmbajtje tjera

2.3.4 Rrugët

2.4 STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

2.4.1 Destinimi i sipërfaqeve

2.4.2 Ndarja në tërësi hapësinore

3.0. RREGULLAT URBANE DHE MËNYRA E PËRTRIRJES SË GJENDJES EKZSITUESE

3.1 BANIMI

3.1.1 Tipologjitë e banimit

3.1.2 Kushtet e vendosjes së ndërtesave dhe përmbajtjet

3.2 PËRMBAJTET JO-BANIMORE

3.2.1 Institucionet arsimore

3.2.1.1 Qerdhet/kopshtet

3.2.1.2 Shkolla fillore dhe e mesme e ultë

3.2.2. Institucionet shëndetësore

3.2.2.1 Qendra e mjekësisë familjare

3.2.3. Ndërtesat tjera për shërbime publike

3.2.3.1 Qendra e sigurisë

3.2.4 Ndërtesat për kulturë, sport dhe rekreim

3.2.4.1 Qendra e komunitetit

3.2.4.2 Ndërtesat e sportit dhe rekreimit

3.2.5 Ndërtesat me destinim të veçantë

3.2.5.1 Ambasada e SHBA-ve

3.3 INFRASTRUKTURA RRUGORE DHE TRAFIKU

3.3.1 Kategorizimi i rrugëve

3.3.1.1 Hekurudha

3.3.1.2 Treni urban

3.3.1.3 Unaza qendrore

3.3.2 Elementet e profilit tërthor të rrugëve

3.3.3 Trafiku

3.3.3.1 Orientimi i trafikut

3.3.3.2 Kufizimi i shpejtësisë

3.3.3.3 Regjimi i lëvizjes së autobusëve dhe mjeteve të rënda

3.3.4 Transporti publik

3.3.5 Trafiku i qetë

3.3.5.1 Biciklistët

3.3.5.2 Lëvizja e këmbësorëve

3.3.5.3 Nënkalimi dhe mbikalimet

3.3.6 Vendparkimet

3.4 HAPËSIRAT E PANDËRTUARA

3.4.1 Sipërfaqet e gjelbërta

3.4.2 Hapësira e lirë publike

3.4.2.1 Parku i lagjes-parku i Prishtinës

3.4.2.2 Hapësirat e gjelbërta në kuadër të banimit

3.4.2.3 Rrjeti i arterieve të gjelbërta të lagjes

3.4.2.4 Gjelbrimi izolues

3.4.2.5 Varrezat

3.5 MBROJTJA E MJEDISIT

3.5.1 Mbrojtja e ajrit

3.5.2 Mbrojtja nga zhurma

3.5.3 Mbrojtja nga zjarri

3.5.4 Trajtimi i mbeturinave

3.5.5 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis

3.6 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

3.6.1. Rrjeti i ujësjellësit

3.6.2 Rrjeti i kanalizimit

3.6.2.1 Rrjeti i kanalizimit fekal

3.6.2.2 Rrjeti i kanalizimit atmosferik

3.6.3 Rrjeti primar i ngrohjes qendrore

3.6.4 Furnizimi me energji elektrike

3.6.5 Rrjeti telekomunikues

3.7 RIKAPITULLIM- KUSHTET URBANISTIKE SIPAS TËRËSIVE DHE BLOQEVE

4.0 EVIDENTIMI I NDRYSHIMEVE NË MES TË PLANEVE

4.1 EVIDENTIMI I NDRYSHIMEVE NË MES TË PLANIT ZHVILLIMOR URBAN DHE PLANIT RREGULLUES URBAN TË REVIDUAR

4.2 EVIDENTIMI I NDRYSHIMEVE NË MES TË PLANIT RREGULLUES URBAN EKZISTUES DHE PLANIT RREGULLUES URBAN TË REVIDUAR

5.0 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME TË RREGULLIMIT

5.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME

5.2 OBJEKTET EKZISTUESE DHE ATO NË NDËRTIM E SIPËR

5.3 RIPARCELIMI

5.4 FORMAT E IMPLEMENTIMIT TË BLOQEVE

5.5 BASHËKPRONËSIA

5.6 PROJEKTET PËR ZHVILLIM

6.0 DISPOZITAT LIDHUR ME PËRGJEGJËSITË, BASHKËPUNIMIN DHE PJSËMARRJEN

6.1 DISPOZITAT E FUNDIT DHE KALIMTARE

6.2 ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM

LISTA E FIGURAVE, HARTAVE DHE TABELAVE

FIGURAT

Fig. 1 Skenarët e zhvillimit: a) Skenari 1; b) Skenari 2

Fig. 2 Skenarët e zhvillimit- Rrjeti rrugor a) Skenari 1; b) Skenari 2

Fig. 3 Skenarët e zhvillimit- Banimi a) Skenari 1; b) Skenari 2

Fig. 4 Skenarët e zhvillimit- Arsimi a) Skenari 1; b) Skenari 2

Fig. 5. Skenari I përzgjedhur

Fig.6 Lexueshmëria e lokacionit a) gjendja ekzsituose; b) propozimi

Fig 7. Rruga kryesore urbane "Ahmet Krasniqi"- segmenti I bulevardit

Fig 8. Rruga kryesore urbane "Ahmet Krasniqi".

Fig. 9 Profili I unazës qendrore bashkë me binarët dhe rrugën paralele

Fig 10. a) Rrugë kryesore urbane- profili rrugor pranë ndërtesës së Komunës- "C-C"; b) rrugë përmbledhëse- profil- rrugor afër zonës ekonomike, prerja "D-D"; c) rrugë përmbledhëse-profil rrugor afër MiniMax "E-E".

Fig 11. a) rrugë banimi "H-H"; b)rrugë banimi "F-F"; c) rrugë banimi "G-G"

Fig.12 Linjat e autobusëve

Fig.13. Vendndalja e autobusëve

Fig.14 Raporti mes rrugëve me shirit të veçantë për biciklistë dhe shirit të integruar.

Fig.15 a) Zonat me ndikim të mundshëm të ndotjes b) mundësia e uljes së nivelit të ndotjes përmes planifikimit

Fig 16. : Nxehtësia e nevojshme specifike mesatare maksimale për objektet e banimit dhe për objektet afariste për m2 të sipërfaqes e cila shfrytëzohet.

Fig. 17: Vlerat orientuese për nxehtësinë specifike të ngrohjes, në varësi nga vjetërsia dhe raporti A/V (sipërfaqja e jashtme përfshirëse ndaj vëllimit).

Fig. 18: Nxehtësia e nevojshme specifike mesatare maksimale për objekte të fabrikave për m3 të hapësirës

Fig.19. Detali I kanalit, kanali ne kthesa dhe detali i saldimit .

Fig 20 . Kanalizimi kablllovak

Fig.21 Vija ndërtimore ne vertikale

Fig. 22. Parcela 6177 pjesë e bllokut A2, B9 a) gjendja ekzsituose;b)sipas PRRU-së së vjetër; c) sipas planit të reviduar.

Fig. 23. Pjesa lindore e bllokut C4 a) gjendja ekzsituose;b)sipas PRRU-së së vjetër; c) sipas planit të reviduar.

TABELAT

Tab.1 Vlerësimi I skenarëve

Tab.2 Pasqyrë e vlerave të dendësisë së banimit dhe koeficientit të lejuar në ndërtesat shumëkatëshe

Tab.3 Llogaritja e numrit të banorëve në bazë të dendësisë së banimit

Tab.4 Llogaritja e numrit të banorëve në bazë të koeficientit të lejuar.

Tab.5 Numri I parashikuar I banorëve

Tab. 6 Shfrytëzimi I tokës- kategoritë themelore

Tab. 7. Sipërfaqet e zonave karakteristike të Arbëria 3.

Tab.8 Dendësia banimore.

Tab.9. Banimi- kushtet e rregullimit.

Tab 10. Sipërfaqja e lirë në raport me kategoritë kryesore të shfrytëzimit të tokës

HARTAT

Harta 1. Shfrytëzimi I tokës

Harta 2. Ndarja në blloqe

Harta 3. Banimi

Harta 4. Rrjeti rrugor-hierarkia

Harta 5. Hapësirat e gjelbërta

Harta 6 Projektet për zhvillim në lagjen Arbëria 3

C) PROPOZIMI

1.0 SKENARËT E ZHVILLIMIT

Hartimi i skenarëve të zhvillimit kanë pasur për qëllim hulumtimin e alternativave të zhvillimit. Zgjidhja më e mirë urbane nga aspekti i përmbushjes së standardeve për një ambient më të shëndoshë, qasje më të mirë e ambient më të pastër nuk është gjithmonë zgjidhja e realizueshme.

Nisur nga planet e mëhershme (PRRU "Arbëria 3" Ref., draft PZHU) si dhe hulumtimi në terren janë hartuar dy skenarë:

- Skenari 1, me minimum ndryshime që do të thotë minimum ekspropriim dhe parcelizim, minimum dislocim dhe sa më pak investim publik dhe minimum ndryshim të shfrytëzimit të rrjetit ekzistues rrugor
- Skenari 2, me mesatarisht ndryshime që do të thotë më shumë nevojë për ekspropriim dhe parcelim.

Skenari 1 është opsion më lehtë i realizueshëm.

Vlerësimi i skenarëve është bërë duke inicuar pyetjet se cili skenar është më i mundshëm në aspektin financiar, më i dëshiruar nga komuniteti, në përputhje më synimet që ka komuna, lehtë i realizueshëm në kontekst të pronës, më i dëshirueshëm në aspektin ambiental dhe zgjidhje më e mirë hapësinore.



Fig. 1 Skenarët e zhvillimit: a) Skenari 1; b) Skenari 2

1.1 VLERËSIMI I SKENARËVE

SKENARI 1	
minimum ndryshime	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
planfikimi i përmbajtjeve publike përgjatë arteries kryesore (definimi i qendrës së lagjes)	kryqëzimi tek rrethi në hyrje të Arbërisë (drejtimi nga Mitrovica)
shfrytëzimi i rrugëve, traseve ekzistuese	disa qerdhe të planfikuar në pronë private
përmbajtjet publike të planfikuar në tokë publike	mungesa e një parku qëndror
shprëndarja e shkollave në dy zona (zona e	

SKENARI 2	
mesatarisht ndryshime	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
shfrytëzimi pjesërisht i rrugëve, traseve ekzistuese	përmbajtjet publike të planfikuar në tokë private
parku i lagjes	përmbajtjet publike më të shprëndara
	devijimet e rrugëve kryesore
	koncentrimi i shkollave në zonën e sipërme

Tab.1 Vlerësimi i skenarëve

BANIMI

S1,S2- banim i ultë, mesëm dhe i lartë

S1,S2- kryesisht i planifikuar sipas planeve

SPORTI DHE REKREIMI

S1, S2- kryesisht sipas planeve

ARSIMI PARAFILLOR

S1,S2- aty ku ka shkollë të këtë edhe qerdhe, pozita varet në raport me pozitën e shkollës, shfrytëzimi i standardit të mbulueshmërisë.

ARSIMI

S1- shkolla fillore në zonën e poshtme (hapësira afër ndërtesës së komunës)

S2- shkolla fillore në zonën e sipërme (afër zonës së banimit të mesëm)

PËRMBAJTET PUBLIKE

S1- në raport me lokacionin e ambasadës së SHBA-ve

S2- kryesisht përgjatë arteries kryesore (rrugës "A.Krasniqi")

HAPËSIRAT E GJELBËRTA

S1,S2- fushëlojat në çdo tërësi (0.2-0.3 ha)

S2- parku kryesor përballë lokacionit të ambasadës.

Dallimet mes skenarëve:

S1,S2- lokacionet e shkollave dhe qerdheve

S1- shfrytëzimi I zonës përballë lokacionit të Ambasadës Amerikane për banim të mesëm.

S2- eliminimi I banimit tek zona e ambasadës dhe shfrytëzimi I saj për përmbajtte publike

S1,S2- shfrytëzimi I rrugëve ekzistuese të banimit, eliminimi I rrugëve të tepërta, mundësimi I qasjes nga një rrugë për qasje përgjatë hekurudhës.

RRJETI RRUGOR

Qëllimi kryesor:

- Lidhja më e mirë me rrethinën
- Ndërtimi I një rrjeti rrugor të sigurtë dhe të depërtueshëm brenda lokacionit
- Respektimi dhe shfrytëzimi I rrugëve ekzistuese
- Shfrytëzimi I korridoreve të mundshme për depërtim.



Fig. 2 Skenarët e zhvillimit- Rrjeti rrugor a) Skenari 1; b) Skenari 2

Dallimet mes skenarëve:

S1- shfrytëzimi I arteries kryesore (rruga "A.Krasniqi") sipas trasesë ekzistuese

S2- arteria kryesore ekzistuese (rruga "A.Krasniqi") shmanget dhe shkarkohet në rrugën e zonës ekonomike

S1,S2- shfrytëzimi I rrugëve ekzistuese të banimit, eliminimi rrugëve të tepërta, mundësimi I qasjes nga një rrugë për qasje përgjatë hekurudhës.

BANIMI

Qëllimi kryesor:

- Ngritja e kualitetit të banimit
- Ruatja e pronës private dhe mënyrës së shfrytëzimit të saj

- Lloji I banimi I planifikuar sipas planeve të mëhershme




Fig. 3 Skenarët e zhvillimit- Banimi a) Skenari 1; b) Skenari 2

Dallimet mes skenarëve:

S1- shfrytëzimi I zonës përballë lokacionit të Ambasadës Amerikane për banim të mesëm.

S2- eliminimi I banimit tek zona e ambasadës dhe shfrytëzimi I saj për përmbajte publike

S1,S2- sipërfaqet për banimi të planifikuara sipas planeve të mëhershme

ARSIMI

Qëllimi kryesor:

- Sigurimi I kushteve për shkollim
- Planifikimi bazuar në kapacitet
- Distançë sa më e shkurtër ecjeje



Fig. 4 Skenarët e zhvillimit- Arsimi a) Skenari 1; b) Skenari 2

Dallimet mes skenarëve:

S1,S2- lokacionet e shkollave dhe qerdheve

S2- përcëndrimi në pjesën me dendësi më të madhe banimi

S1- mbulueshmëria e pjesës së sipërme të lagjes

SKENARI I PËRZGJEDHUR

Në mënyrë që plani të jetë më i plotë dhe gjithpërfshirës, autorët kanë paraprë involvimin e banorëve, pronarëve dhe të gjithë shfrytëzuesit e kësaj lagje si pjesë aktive të procesit. Për këtë arsye është organizuar një takim pune në të cilën të gjithë pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të marrin direct pjesë në hartim të planit.

Nga ky takim është nxjerrë një listë me kërkesa, të cilat janë prezentuar në bazë të prioritetit :

- Rritja e etazhitetit – te zona e sipërme e lagjes
- Zgjerimi i profileve rrugore
- Mungesa e hapësirave të gjelbërta
- Planifikimi i institucioneve publike në tokë me pronësi publike e jo private

Të gjitha këto kërkesa janë identifikuar direkt në hartat punuese (për më shumë info shih. Dokumentin "Procesi- Takimi I parë publik punues, Mjetet e punës").



Fig. 5. Skenari I përzgjedhur

2.0 PLANI RREGULLUES – ELEMENTE TË PËRGJITHSHME

2.1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

2.1.1 Emri i planit

Emri i planit është Rishikimi I Planit Rregullues urban "Arbëria 3" në Prishtinë , në vazhdim të tekstit: Plani.

2.1.2 Baza ligjore për planin

Ndryshimi dhe plotësimi I planit rregullues urban "Arbëri 3" , është i bazuar në:

-Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor, nr 04/L-174

-Ligjin për ndërtimin, nr.04L/-110

-Udhëzimin administrativ për zbatimin e ligjit për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të planit rregullues urban

-Udhëzuesin për planifikim hapësinor të vendbanimeve joformale

-Udhëzuesi administrativ mbi procedurën e shqyrtimit publik për Planet Hapësinore

2.1.3 Elementet identifikuese të planit

Kufiri i planit

Kufiri i planit është i paraqitur në pjesën grafike "Kufijtë e hapësirës që trajtohet", P=1:1000, dhe është i përcaktuar nga kufijtë e parcelave kadastrale.

Lokacioni është i kufizuar me:

-hekurudhën Prishtinë- Beograd (anën juglindore)

-rrugën nacionale Shkup-Mitrovicë (anën jugperëndimore)

-zonën e banimit të ultë të Arbërisë 1 dhe KFOR (anën verilindore)

-zonën ekonomike (anën veriperëndimore)

Zona e përfshirë me plan rregullues (Lokacioni) është e kufizuar me këto bashkësi lokale:

-BL "Arbëria 1", BL "Arbëria 4", BL "Lakrishte, Pejtoni, Qendra Universitare", BL "Qendra"

Sipërfaqja e planit

Plani përfshinë sipërfaqen prej 87¹ ha.

Parcelat kadastrale

Me këtë plan janë përfshirë gjithsej 268 parcela:

2953-0, 2952-0, 2957-0, 2966-0, 2970-0,2969-0, 2983-0, 2982-0, 3012-0, 2956-1, 3011-0, 2948-0,2960-0, 2961-0, 2958-0, 2959-4, 7505-0, 7502-0, 7501-0,7199-0, 7195-0, 7191-0, 7194-0, 7198-0, 7499-0, 7500-0, 7193-0, 7192-0, 7189-0, 7188-0, 7181-0, 7180-0, 6176-0, 7179-2, 7176-0, 7174-0, 7175-0, 7170-0, 7173-0,7164-0, 7166-0, 7167-0, 7168-0, 7165-0 , 7163-0, 6189-0, 6178-0, 6177-1, 6173-0, 7504-0, 6175-0, 7745-

¹Vërejtje: me kufinj të dhënë për rishikimin e planit në bazë të detyrës projektuese, lagja përfshinë sipërfaqen prej 89 ha, çka do të thotë që analiza është bërë për këtë sipërfaqe.. Mirëpo gjatë fazës së propozimit për shkak se kufiri veriperëndimor është definuar me rrugën e zonës ekonomike, sipërfaqja është zvogëluar në 87 ha.

0, 90167-0, 7190-0, 7177-4, 7177-6, 7177-7, 2954-1, 2954-10, 2954-11, 2954-12, 2954-9, 2954-8, 2954-2, 2954-3, 2954-4, 2954-5, 2954-6, 2954-7, 2956-4, 7183-0, 7184-0, 2965-6, 2965-7, 2965-2, 2967-4, 2967-10, 2967-9, 2967-8, 2967-17, 2967-7, 2967-6, 2967-2, 2968-5, 2968-3, 2968-4, 2968-7, 2968-6, 2962-16, 2962-15, 2962-14, 2962-13, 2962-17, 2962-11, 2962-10, 2962-9, 2962-8, 2959-3, 2955-6, 2955-4, 2955-3, 2955-7, 2962-2, 2950-1, 2950-3, 2950-2, 2950-4, 6179-7, 6179-6, 6179-8, 6179-5, 6179-4, 6179-3, 6179-9, 6179-10, 6179-2, 7172-5, 7172-4, 6179-11, 6179-12, 6179-1, 2955-2, 2967-3, 2967-15, 2967-14, 2967-13, 2967-12, 2967-11, 2955-5, 2955-1, 2967-16, 2973-26, 7177-3, 6177-3, 6177-2, 7172-3, 7182-4, 7182-2, 7169-1, 7169-2, 7169-3, 2956-2, 2956-3, 6170-2, 2981-5, 2981-3, 2981-4, 2968-2, 2968-8, 2968-9, 2965-4, 2965-3, 2965-1, 2959-6, 2959-2, 2967-18, 2967-5, 2967-19, 6172-5, 7172-21, 7172-20, 7172-19, 7172-18, 7172-17, 7172-16, 7172-15, 7172-14, 7172-13, 7172-11, 7172-9, 7172-24, 7172-6, 7172-7, 7172-8, 7172-10, 7172-12, 7172-23, 7177-13, 7172-1, 7182-3, 6171-6, 6171-1, 6171-2, 6171-3, 6171-5, 6171-4, 7171-15, 7171-11, 7171-12, 7171-13, 7171-14, 7171-4, 7171-5, 7171-7, 7171-6, 7171-8, 7171-9, 7171-3, 7171-1, 7171-2, 7171-10, 7177-9, 7177-10, 2962-18, 7197-2, 7197-4, 7177-11, 7197-3, 7177-12, 2984-1, 2984-2, 2984-3, 2984-4, 2984-9, 2984-8, 2984-7, 2984-6, 2984-5, 2984-10, 7172-25, 7172-26, 7177-25, 7177-14, 7177-24, 7177-23, 7177-22, 7177-21, 7177-20, 7177-19, 7177-18, 7177-17, 7177-16, 7177-15, 7177-28, 7177-26, 6170-3, 6170-4, 6170-5, 6170-6, 6170-8, 6170-9, 6170-7, 7178-11, 7178-8, 7178-9, 7178-10, 7178-5, 7178-7, 7178-6, 7178-1, 7178-2, 7178-4, 7178-3, 6172-7, 6172-8, 6172-9, 7662-11, 2951-0, 7177-29, 2968-10, 2968-11, 7179-1, 7662-12, 7196-0, 2965-9, 2965-5, 2965-8, 10077-0.

Ndarja në tërësi

Parcela urbane paraqet njësinë më të vogël të tokës e cila është definuar me rregulla të ndërtimit.

2.2 KORNIZA E ZHVILLIMIT

2.2.1 Synimet e zhvillimit

Duke e pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e ndryshme në implementimin e planit, rëndësinë dhe potencialet që I ofron lagja ' Arbëria 3' si dhe interesi për rregullim të hapësirave dhe ndërtim, autoritetet komunale kanë marrë vendim për rishikimin e planit rregullues urban (PRRU "Arbëria 3" Ref. L-01-81/04) I cili përfshinë zonën prej 87 ha, të përcaktuar me Plan Strategjik.

Sipas detyrës projektuese duhet të bëhet ndryshimi si dhe plotësimi I planit respektivisht plotësimi I gjendjes faktike, plotësimi I gjendjes faktike me lejet e lëshuara, plotësimi me projektet e hartuara dhe ato që janë në hartim e sipër, harmonizimi I kritereve etj.

Si bazë meritorë për përcaktimin e qëllimeve të zhvillimit janë marrë objektivat e zhvillimit urban, principet elementare të planifikimi dhe dizajnit urban, kërkesat e banorëve, vlerësimet e gjendjes aktuale si dhe interesi I autoriteteve për t'a rregulluar hapësirën e qytetit.

Objektivat e zhvillimit:

- Përparimi I shërbimeve ekzistuese
- Ofrimi I shërbimeve të nevojshme që mungojnë
- Zhvillimi I infrastrukturës rrugore, të ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike
- Rritja e shanseve për punësim
- Ruatja e stabilitetit ekologjik dhe pasurive të veçanta natyrore
- Ulja e ndotjes së ajrit

Nga analizat e bëra si dhe diskutimin me komunitetin janë përcaktuar qëllimet e zhvillimit:

- Harmonizimi I kërkesave individuale të komunitetit dhe interesave të përgjithshme
- Shfrytëzimi I mundësive që ofron lagja dhe harmonizimi me synimet zhvillimore të tij
- Hartimi I një plani të implementueshëm duke respektuar parimet për ambient të qëndrueshëm dhe të shëndoshë.

Për arritjen e këtyre qëllimeve janë përcaktuar synimet specifike:

- Sigurimi I banimit adekuat si dhe hapësirave përcjellëse të tij
- Sigurimi dhe përmirësimi I rrjetit funksional rrugor duke shfrytëzuar maksimalisht rrugët dhe korridoret ekzistuese
- Definimi I blloqeve urbane për rregullim
- Rikonstrumi I zonave të banimit me qëllim të krijimit të kushteve më të mira të banimit, përmbushjes së kërkesave të banorëve për një jetë më të shëndetshme dhe funksione përkatëse.
- Lehtësimi I livizjës së banorëve
- Ruajtja dhe përparimi I hapësirave publike ekzistuese
- Sigurimi I përmbajtjeve të reja publike
- Ruajtja dhe përparimi I hapësirave të gjelbërta të lagjes
- Formësimi I strukturës fizike duke respektuar paternën ekzistuese

2.2.2 Koncepti

Koncepti është gjeneruar duke u bazuar në paternën rrugore e cila ka ndihmuar në identifikimin e paternës së re- asaj të ardhmes.

Në lokacion kemi kombinim të dy paternave:

- ortogonale , e cila përfaqësohet prej rrugëve ortogonale të lidhura dhe të palidhura (zonën e sipërme)
- gjeomorfologjike e cila lidhet me topografinë e lokacionit (zonën e poshtme).

Për t'a shfrytëzuar këtë tipar të lokacionit dhe vërtetuar nëse mund të përdoret për krijim e paternës së re, është përdorur analiza hapësinore përmes softverit "Depthmap". Përmes kësaj analize është parë se sa është i lexueshëm lokacioni dhe në cilat pjesë duhet intervenuar për të krijuar një rrjet rrugor të ndëlidhur , e cila ndikon në ngritjen e kualitetit të lokacionit.




Fig.6 Lexueshmëria e lokacionit a) gjendja ekzistuese; b) propozimi

2.3 KËRKESAT E PËRGJITHSHME

2.3.1 Popullsia dhe banimi

'Arbëria 3' ka afërsisht 5500 banorë banorë me tendencë të shtimit të popullsisë. Në bazë të hulumtimeve të fundit (korrik 2013) janë edhe 496 njësi banimi të gatshme për banim (tek banimi kolektiv janë 1391 njësi banimi prej të cilave 895 janë në funksion, ndërsa 496 pritet që së shpejti të vihen në funksion). Sipas planeve (PZHU-së, PRRU-së) Arbëria 3 është zonë e banimit kolektiv me një përqindje të vogël të banimi të ultë.

Në bazë të zhvillimeve të reja në lokacion, marrë për bazë sipërfaqen e banimit dhe katësinë e tij në lagjen Arbëria3 numri I parashikuar I banorëve mund të variron prej 16000-18000 varësisht nga parametri I përvetësuar.

Llogaritjet lidhur me numrin e popullsisë janë bërë duke u bazuar në dendësinë banimore dhe koeficientin e lejuar.

SIPAS DENDËSISË BANIMORE		SIPAS SIPËRFAQËS PËR BANORË		
Katësia	ban/ha	Katësia	Ksh	m2/ban
P+3	300	P+4	1.1	30
P+4	325			
P+5	350			
P+6	375	P+5	1.2	28
P+8	400	P+6	1.2	28
P+10	500			

Tab.2 Pasqyrë e vlerave të dendësisë së banimit dhe koeficientit të lejuar në ndërtesat shumëkatëshe².

Në bazë të vlerave të mësipërme dhe sipërfaqes së propozuar për banim rrjedh se numri I parashikuar I banorëve për zonat e reja është:

- Sipas dendësisë banimore:

Katësia	ha	ban/ha	gjithsej
P+3	22.38	300	6714
P+4	4.38	325	1424
P+6	1.54	375	578
P+8	1.1	400	440
GJITHSEJ BANORË	29.4		8578

Tab.3 Llogaritja e numrit të banorëve në bazë të dendësisë së banimit

² Dieter Prinz (2010) *STADTENBAU-URBANIZMI*, VËLLIMI 1- PLANIFIKIMI URBANISTIK. Gjermani (fq.201 dhe 208)

- Sipas koeficientit të lejuar:

Katësia	ha	Ksh	Ksh*ha	Ksh*m2	m2/ban	Kshm2/ 30
P+3	22.38	1.1	24.618	246180	30	8206
P+4	4.38	1.2	5.256	52560	28	1877
P+6	1.54	1.2	1.848	18480	28	660
P+8	1.1	1.2	1.32	13200	28	471
GJITHSEJ BANORË						10555

Tab.4 Llogaritja e numrit të banorëve në bazë të koeficientit të lejuar.

Në bazë të numrit aktual të banorëve **B1**, numrit që priten të banojnë në ndërtesat në përfundim e sipër **B2** dhe numrit të parashikuar të banorëve **B3**, rrjedh se numri i gjithmbarshëm i banorëve është:

		njësi	an/fam	gjithsej banorë
B1	Shtëpi ekzistuese	194	5	970
	Banesa ekzistuese	895	5	4475
B2	Banesa në përfundim e sipër	496	5	2480
	Shtëpi të reja	45	5	225
B3	Banorë të parashikuar	*		8578
GJITHSEJ BANORË (B1+B2+B3)				16728
*	shih tabelat e dendësisë së banimit dhe koeficientit të lejuar			

Tab.5 Numri i parashikuar i banorëve

2.3.2 Institucionet publike

Në bazë të kërkesave dhe standardeve për zhvillim të shëndoshë të komunitetit parashihen shërbimet themelore si: institucionet e arsimit, institucionet e shëndetësisë etj.

2.3.2.1 Arsimi

Një ndër problemet e cekuara gjatë rishikimi të planit është numri dhe shpërndarja e institucioneve arsimore (shih. "Analiza e situatës ekzistuese" fq. 23). Në bazë të numrit të banorëve nevojiten : 7 qerdhe/kopshte, 3 shkolla fillore dhe 1 shkollë e mesme. Në anën tjetër nëse mirret zona e mbulueshmërisë rrjedh se me një shkollë pothuajse mund të mbulohet territori i lagjes. Për këtë arsye autorët bashkë me ekipin nga komuna kanë ardhur në përfundim që të bëhet një lloj kombinim në mes të parametrave: rreze-numër të banorëve- kapacitet të shkollës, çka është ardhur në përfundim që të propozhen dy shkolla me kapacitet më të madh dhe 5 qerdhe kopshte. Rritja e kapacitetit të shkollës lidhet edhe me fokusimin e dendësive të larta të banimit në zona të caktura(psh. zona e poshtme) . Për këtë arsye parcelat për shkolla janë planifikuar më të mëdha.

Sa I përket arsimit të mesëm, është propozuar që lokacioni I saj të jetë në zonën ekonomike e në të cilën shkollë do të zhvillohej një kurrikulë e cila lidhet më karakteristikat e zonës dhe do t'i shërbente edhe qytetit në tërësi.

Lidhur me standardet e planifikimit të shkollave dhe qerdheve *shih. "Analiza e situatës ekzistuese" fq. 25.*

2.3.2.2 Shëndetësia

Bazuar në gjendjen aktuale dhe standardeve lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore është planifikuar një qendër e mjeksësisë familjare. Kjo ndërtesë është vendosur përgjatë arteries kryesore duke I ofruar kështu qasje adekuate për të gjithë banorët.

1 QMF/ 10.000 banorë. Distanca 500-2500 m.

2.3.2.3 Administrata

Në këtë kategori bën pjesë ndërtesa e komunës e cila veç ekziston në lagje. Gjatë hartimit të planit është propozuar që të bëhet ridizajnimi I oborrit duke e bërë ndarjen e qartë në mes të lëvizjeve të veturave dhe këmbësorëve. Gjithashtu duhet parashikuar edhe hapësirën e lirë të gjelbërt dhe të gjitha elementet mikrourbane.

2.3.2.4 Qendra e sigurisë

Një ndër kërkesat e banorëve por edhe detyrimet që rrjedhin nga PRRU-ja është planifikimi I qendrës së sigurisë e cila përfshinë stacionin policor dhe të zjarrëfikësve. Pozita e kësaj qendre të sigurisë lidhet me kërkesat specifike të tyre, si psh. qasja nga nivele të ndryshme rrugore, komunikimi përmes pikave të ndryshme dhe raporti me arterien kryesore të lagjes. Kjo qendër I shërben lagjes Arbëria 3.

2.3.3 PËRMBAJTJE TJERA

2.3.3.1 Ndërtesat sportive në kuadër të parkut

Për lagje por edhe për tërë qytetin e Prishtinës janë paraprë dy komplekse në të cilat mund të zhvillohet sporti dhe rekreimi: parku I lagjes dhe zona e rekreimit me fusha në të hapur dhe përmbajtje tjera .

2.3.3.2 Varrezat- në plan janë trajtuar si pjesë e rrjetit të gjelbër. Më poshtë është dhënë propozimi lidhur me trajtimin e tyre.

2.3.4 RRUGËT

Koncepti I zhvillimit ofron mundësi për përmirësimin e rrjetit rrugor si dhe komunikim më të mirë me përmbajtjet tjera të lagjes si dhe të zonave përreth.

Qëllimi kryesor I planit është krijimi I një rrjeti funksional, të lehtë dhe mbi të gjitha të sigurt për banorët e lagjes Arbëria 3. Për arritjen e këtyre qëllimeve është propozuar zgjerimi I akseve të rrugëve të lagjes, lidhja dhe depërtueshmëria e tyre, gjithmonë duke e shfrytëzuar në maksimum rrjetin ekzistues rrugor.

2. 4 STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

2.4.1 Destinimi i sipërfaqeve

Në bazë të kategorizimit të përgjithshëm, lagja ndahet në sipërfaqe të ndërtuar, sipërfaqe të lirë dhe sipërfaqe të transportit. Lagja përfshinë sipërfaqe prej 87 ha.

Toka ndërtimore është kryesisht e destinuar për banim 50.64 % apo 44.08 ha, prej të cila 7.08 % apo 6.16 ha janë banim I ultë, 30.11% apo 26.21 ha janë banim I mesëm dhe 13.45% apo 11.71 ha banim I lartë. Përmbajtet tjera publike si institucionet sociale, administrative, përfshijnë sipërfaqe prej 9.86ha apo 11.32%.

Sipërfaqet e lira publike përbëjnë një hapësirë prej 14.71 ha apo 16.9 % ndërsa sipërfaqet për transport 18.39 ha apo 21.12 %.

Ndonëse autorët janë bazuar në PZHU dhe PRRU lidhur me destinimin dhe katësitë e ndërtesave, banimi I lartë si tipologji e trashëguar nga situata aktuale mbetet si një tipologji dominante në zonën e poshtme. Përmbajtet tjera janë të shpërndarë nëpër lagje, bazuar në standardet e mbulueshmërisë por edhe duke u bazuar në llojin e pronës.

Edhe pse lagja ka hapësirën për sport dhe rekreim, në hapësirat e lira të blloqeve të banimit si dhe në kuadër të parqeve janë paraparë fushat për sport. Për shkak të krijimit të një balasi në mes të ambientit të ndërtuar dhe të pandërtuar është paraparë rrjeti I gjelbërt nëpër tërë lagjen e cila është pjesë përbërëse e çdo kompleksi banesor, blloku urbanistik si dhe I lagjes në tërësi. Ky lloj gjelbërimi është quajtur gjelbërimi I bllokut.

Për shkak të kërkesave lidhur me zonat e veçanta (Zona e Ambasadës së SHBA-ve dhe varrezat) është paraparë edhe gjelbërimi izolues. Edhe ky lloj gjelbërimi mund të fisnikëroj edhe më shumë hapësirat publike të lagjes. Shëshet e reja do të jenë pjesë e blloqeve të banimit.

Me zgjerimin e traseve rrugore dhe shtimin e rrugëve të reja si dhe parkingjeve, sipërfaqja e transportit do të arrijë deri në 16.29 ha, prej të cilave 0.48 janë shtigje të veçanta për biciklistë dhe 4.97ha trotuare. Parkingjet përgjatë rrugëve janë 2.41 ha. Korridori I rrugëve do të përmbajë shirit dyanësor të automjeteve, shtigjet për këmbësorë dhe shiritat e gjelbërimit. Përkundër topografisë së ndryshueshme të lagjes, në disa rrugë janë paraparë shtigjet për çiklistë.

1	BANIM INDIVIDUAL	ha	6.16
		%	7.08
2	BANIM SHUMËBANESOR	ha	37.92
		%	43.57
3	ARSIM	ha	2.75
		%	3.16
4	SHËRBIME PUBLIKE	ha	1.64
		%	1.88
5	AMBASADA E SHBA-ve	ha	5.28
		%	6.07
6	RELIGJION	ha	0.19
		%	0.22
7	VARREZA	ha	3.86
		%	4.43
8	PARQET	ha	4.64
		%	5.33
9	SPORTI DHE REKREIM	ha	3.3
		%	3.79
10	GJELBËRIM IZOLUES	ha	2.91
		%	3.34
11	RRUGË	ha	10.84
		%	12.45
12	SHTIGJET E CIKLISTEVE	ha	0.48
		%	0.55
13	PARKINGJE	ha	2.10
		%	2.41
14	TROTUARE	ha	4.97
		%	5.71
GJITHSEJ LAGJA 'ARBËRIA 3'		ha	87.04
		%	100.00

Tab. 6 Shfrytëzimi i tokës- kategoritë themelore



Harta 1. Shfrytëzimi i tokës

2.4.2 Ndarja në tërësi hapësinore

Ndarja në tërësi hapësinore është bërë duke u bazuar në ndarjet e mëparshme por me disa ndryshime të vogla. Këto ndarje janë bërë duke u bazuar në karakteristikat e lokacionit ku njëherit mundësohet krijimi i tërësive funksionale dhe përkufizimit me system efikas rrugor.


Sipas këtij zonimi, lagja Arbëria 3 ndahet në 5 zona: zona e fshatit, qendrës, verandës, prerisë dhe parkut.

ZONAT		%	ha
	ZONA "FSHATI"	15.09	9.9
	ZONA "QENDRA"	23.06	15.13
	ZONA "VERANDA"	19.86	13.03
	ZONA "PRERIJA"	18.00	11.81
	ZONA "PARKU"	24.00	15.75
GJITHSEJ (ha) PA RRUGË			65.62



Tab. 7. Sipërfaqet e zonave karakteristike të Arbëria 3.

Vërejtje : në këto sipërfaqe nuk janë marrë në llogaritje rrugët.



Harta 2. Ndarja në blloqe

3.0 RREGULLAT URBANE DHE MËNYRAT E PËRTËRIRJES SË GJENDJES EKZISTUESE

3.1 BANIMI

Planifikimi I banimit, si funksion dominant I lagjes, është bërë duke u bazuar në analizën e numrit të banorëve dhe kërkesave të vazhdueshme për banim. Meqenëse zona e banimit kolektiv është relativisht zonë e re, gjatë planifikimit lagja është ndarë në tërësi të cilat kërkojnë trajtime të ndryshme:

- Zona e trashëguar me banim kolektiv (e ndërtuar në periudhën 2006-2013)
- Zona e re e planifikuar

Zonën e trashëguar me banim kolektiv e përbejnë:

- Ndërtesat e banimit kolektiv të cilat janë realizuar dhe janë në funksion
- Ndërtesat e banimit kolektiv që janë në ndërtim e sipër
- Zonat e rezervuara për ndërtime kolektive për të cilat janë dhënë leje ndërtimi.

Në bazë të këtyre informatave vijmë në përfundim se zona e poshtme e lagjes është pothuajse e mbuluar me plane. Intervenimi I vetëm në këtë zonë është planifikimi I një qerdhe/kopshti dhe parkut në hapësirën ku nuk ka ndërtim apo nuk është dhënë ndonjë leje ndërtimi.


Zona e re planifikuar- kjo zonë e banimit është planifikuar duke u bazuar në PZHU-në dhe Planin Rregullues Urban "Arbëria 3" si dhe kërkesave të banorëve dhe pronarëve të tokave.

Planifikimi I banimit bazohet në numrin e banorëve, rritjen e dendësisë së banimit dhe rritjen e katësisë, duke I ruajtur kushtet për jetë të shëndoshë- djellosje të mjaftueshme dhe hapësira të lira. Numri I parashikuar I banorëve rreth 17200 banorë (e rritur nga 5500 banorë sa ekzistojnë momentalisht. *Shih "2.3.1 Popullsia dhe banimi"*).

Sipërfaqja e gjithmbarshme e ndërtuar e banimit është 44.08ha. Dendësia banimore për tri zonat karakteristike është: për zonën e banimit individual është 196 ban/ha, për zonën e re të banimi të mesëm është 305 ban/ha, ndërsa tek pjesa e trashëguar është 664 ban/ha. Prej këtyre informatave rrjedh se dendësia përfshirë zonat e banimit është 390 ban/ha.

	ha	ban	ban/ha
Zona me banim individual	6.1	1195	196
Zona e re- banim I mesëm	23.63	7209	305
Zona e trashëguar	11.69	7758	664
GJITHSEJ	41.42	16161	390

Tab.8 Dendësia banimore.



Harta 3. Banimi

3.1.1 Tipologjitë e banimit

Pjesën më të madhe të banimit e përbën banimi I mesëm me sipërfaqe prej 26.21 ha, pastaj banimi I lartë me sipërfaqe prej 11.71 ha dhe banimi I ultë prej 6.16 ha. Banimi I mesëm dhe I lartë është paraparë në zonën "Qendra" dhe "Prerija" dhe etazhiteti I tyre shkon deri në P+4 . Këto ndërtesa duhen të kenë parkingun në brendi të strukturës apo në kuadër të kompleksit. Raporti në mes të sipërfaqes së ndërtuar dhe asaj të lirë është 30%- 70 %.

Banimi I lartë veç I takon pjesës së trashëguar në të cilën bëjnë pjesë komplekset e ndërtuara të banimit dhe ato të cilat janë të pajisura me leje ndërtimi dhe priten të realizohen.

Banimi I ultë mund të përfshijë banimin individual të veçantë, dyshe apo në rend. Në kuadër të banimit individual një ndërtesë përmbanë një njësi banimore d.m.th. një familje (5 anëtarë) dhe lartësia e tyre shkon deri në P+1. Këto ndërtesa mund të kenë parkingun në sipërfaqe të hapur apo brenda.

3.1.2 Kushtet e vendosjes së ndërtesave dhe përmbajtjet

Ndërtesat e banimit duhet të vendosen kah rruga. Grupimi I ndërtesave është kombinuar në formë perimetrike duke u bazuar në kushtet minimale të djellosjes.

Përveç përmbajtjeve të banimit mund të zhvillohen edhe aktivitete afariste- zanate, tregti, hotelieri dhe të ngjajshme duke iu referuar pjesës grafike në të cilën janë përcaktuar boshtet për

banim të përzier. Në zonat e banimit të përzier lejohen vetëm veprimtaritë e qeta dhe të pastra të cilat nuk e pengojnë atë. Nuk lejohen veprimtaritë e zhurmshme dhe të rrezikshme, prandaj ndalohen veprimtaritë prodhuese, shërbimet e papastra të cilat me zhurmë dhe erë e pengojnë banimin apo që paraqesin rrezik nga zjarri dhe eksplozimi.

Veprimtaritë të cilat lejohen janë:

- Zyre administrative, byro dhe të ngjajshme
- Veprimtaritë tregtare dhe hoteliere
- Veprimtaritë zanatesh (rrobaqepës, frizer, fotograf, serviser)

Veprimtaritë e zhurmshme dhe të rrezikshme të cilat nuk lejohen janë:

- Punëtori automekanikësh, zdukthtarë dhe të ngjajshme
- Ndërtesa hoteliere me muzikë të lartë
- Pompa benzine etj.

Shkalla e shfrytëzueshmërisë së tokës (SHsht), për ndërtesat e banimit të ultë individual dhe banimin e mesëm është max.30%. Kjo kushtëzohet drejtpërsëdrejti nga kërkesat minimale për sipërfaqe të gjlebër, për parkingje mbi tokë si dhe për largësinë në mes të ndërtesave.

Vija e rregullimit është e përcaktuar në raport me vijën e trasesë rrugore.

Vija ndërtimore është përcaktuar në raport me vijën e rregullimit. Tek banimi individual, distanca minimale e vijës ndërtimore është 5.0 m. Distanca maksimale 5.0m është e lidhur me rezervimin e sipërfaqes për parkim brenda oborrit. Në rastet kur parcelat kanë formë të papërshtatshme dhe problem në qasje , vija ndërtimore mund të shkon derin në 3.0 m³.

Distanca minimale dhe maksimale tek banimi kolektiv është 7.5 m dhe 10.0 m varësisht nga kategoria dhe profili rrugor. Këto distance janë përcaktuar nga Plani Zhvillimor Urban I Prishtinës⁴.

Rruga "A.Krasniqi" e cila momentalsiht paraqet arterien kryesore dhe kategorinë më të lartë të rrugës brenda lagjes, është shndërruar në një boulevard i cili e bën më human këtë pjesë të lagjes duke bërë një lidhje më organike në mes të ndërtesave të dy fronteve të rrugës.

Kushti themelor që ka përcaktuar distancën mes vijës së rregullimit dhe asaj të ndërtimit është distanca në mes ndërtesave përkatësisht mundësim i djellosjes adekuate.

3.1.2.1 Distanca në mes të ndërtesave

Kushti për largësi ne mes të ndërtesave është, $h+1/2 h$:

- Në ditën me më së paku ndriçim direkt diellor (21 dhjetor), hapësirat e banimit duhet të kenë së paku 2 orë djellosje të drejtpërdrejt (në mes të orës 10-14).

³ Ky rregull nuk vlen për parcelat të cilat i plotësojnë minimumet e kërkuara në kushtet e rregullimit.

⁴ Plani Zhvillimor Urban I Prishtinës 2012-2022. KKPrishtina, Hidroing-DK, Urbanistica(2013). Fq 237

Mirëpo bazuar në PZHU Prishtina, kushti për largësi në mes të ndërtesave është minimum 1 H.⁵ D.m.th plani ka përvetësuar kriterin nga PZHU-ja.

3.1.2.2 Katësia dhe lartësia

Katësia e ndërtesave të banimit të mesëm (zonave re e planifikuar) është P+4 , ndërsa tek banimi I lartë prej P+5 deri në P+8*.

**Katësia P+8 dhe P+7 është paraprë në rastet (C2.4, C2.6) ku në kuadër të parcelave private janë paraparë përmbajtje jobanimore me interes të përgjithshëm. Në rastin C2.4 është paraprë institucioni parashkollor që mund të zhvillohet në përdheshën e ndërtesës së banimit si dhe parku, ndërsa në bllokun C 2.6 është paraparë parku. Këto përmbajtje në marrëveshje me Drejtorinë e Pronës kalojnë në pronë publike.*

Gjithashtu tolerimet, lidhur me rritjen e katësisë deri në maksimumin e paraprë më PZHU në funksion të interesit publik, mund të lidhen edhe me qështjet mjedisore apo kur investitorët duan të realizojnë komplekse banimi të cilat promovojnë arkitekturën e qëndrueshme (psh. rishfrytëzimin e ujërave atmosferike, zvogëlimin e konsumit të energjisë, ngrohja gjeotermale, reciklimin dhe të tjera të ngajshme të cilat promovojnë ambient të qëndrueshëm).

Lartësia më e madhe e strukturave si oxhaqet e ventilimit dhe hapësirat e ashensorëve, mund të lejohen vetëm nëse janë të larguara nga perimetri I ndërtesës për më së paku sa lartësia e vet strukturës. Këto ndërtesa mund të kenë bodrum, përveç në rastet kur kjo është e ndaluar (psh. niveli I lartë I ujërave nëntokësor apo arsye tjera).

Katësia e shtëpive të banimit është P+2 .

3.1.2.3 Parkimi dhe garazhimi

Parkimi I veturave për nevoja të pronarit /shfrytëzuesit të ndërtesave të banimit, të të gjitha llojeve të banimit duhet të sigurohet në parcelën e vet ndërtimore, jashtë sipërfaqes publike të rrugëve, përveç nëse ashtu është përcaktuar me planin e rrjetit rrugor sipas këtij plani.

Standardi I parkimit është 1 vendparkim/1 banesë, me kusht që së paku 20% të planifikohen mbi tokë. Garazhat mund të projektohen nën gabaritin e ndërtesës ose jashtë tij. Në hapësirat e parkimit publik duhet të parashihen parkingjet për personat me aftësi të kufizuar.

3.1.2.4 Raporti I banimit dhe veprimtarive përcjellëse

Raporti I banimit dhe veprimtarive përcjellëse te banimi I përzier nuk është I kufizuar.

Kushtet tjera nga këto të përcaktuara mund të vendosen përmes kushteve të ndërtimit.

⁵ idem

3.1.2.5 Gjellbërimi

Sipas rregullave, raporti në mes të gjellbërimit dhe sipërfaqes tjetër (të ndërtuar apo pllakëzuar) duhet të jetë 50% : 50% tek banimi I ultë ndërsa 40%:60% te banimi I mesëm dhe lartë.

Në parcelën ndërtimore duhet ruajtur sa është e mundur drunjat ekzisues (duhet bërë regjistrimi i drunjëve në parcelën ndërtimore për të cilën puohet plani ideor urb-arkitektonik).

3.1.2.6 Rrethojat

Parcelat e banimit kolektiv nuk duhet të rrethohen.

		VIJA NDËRTIMORE	KATËSIA MAKSIMALE	RAPORTI I SIPËRFAQES SË NDËRTUAR DHE PANDËRTUAR	PARKIMI	GJELBËRIMI
1	BANIMI I ULTË	5.0 m	P+2	30% : 70%	1 vp/1 familje	min.50% e sip. të lirë
2	BANIMI I MESËM	7.5 m	P+4	30% : 70%	1 vp/1 familje	min.40% e sip. të lirë
3	BANIMI I LARTË	7.5 m, 10.0 m	P+6 (P+8)*	30% : 70%	1 vp/1 familje	min.40% e sip. të lirë
*	<i>Katësia P+8 vlen vetëm për bllokun C2.4 për shkak të lëshimit të tokës për qerdhe dhe park si dhe P+7 për bllokun C2.6 për shkak të lëshimit të tokës për park</i>					

Tab.9. Banimi- kushtet e rregullimit.

KUSHTET E NDËRTIMIT PËR BANIM TË ULTË- RIKAPITULLIM:

- PARCELA MINIMALE:
 - për shtëpi të veçanta- min. 400 m²
 - për shtëpi dyshe (apo e ngjitur në një rën anë) , min. 300m²
 - për shtëpi në rend (apo e ngjitur në dy anë), min. 200 m²
- SIPËRFAQJA :
 - e shfrytëzuar brenda parcelës- max. 30 %
 - e bodrumit brenda parcelës max. 60%.
 - e gjellbër brenda parcelës: -min.50%
- DISTANCA :
 - nga fqiu (kufiri I parcelës) ku ka hapje të kthinave primare (si psh qëndrim ditor, dhoma fjetjeje, kuzhina etj) , min.0.75h. (Në rastet kur ka shtëpi ekzistuese atëherë distance minimale mund të jetë 0.5m)
 - nga fqiu (kufiri I parcelës) ku ka hapje të kthinave sekondare (si psh. toalete, depo, shkallë etj) , min.0.25h.
 - nga fqiu (kufiri I parcelës) me marrëveshje- 0 m.
 - bodrumi mund të vendsoet nga fqiu (kufiri I parcelës) në distancë max prej 1.5 m ose 0 m me marrëveshje.
- KATËSIA/ LARTËSIA :

- për katësi P+1 deri te skaji I atikës- max 7m
- për katësi P+0 deri të skaji I atikës – max 4m
- VIJA NDËRTIMORE :
 - 5.0 m
 - 3.0 m *(vetëm tek rastet kur parcela është e vogël dhe ka formë të papërshtatshme për qasje)*

KUSHTET E NDËRTIMIT PËR BANIM TË MESËM DHE TË LARTË- RIKAPITULLIM:

- SIPËRFAQJA :
 - e shfrytëzuar brenda parcelës- max. 30 %
 - e bodrumit brenda parcelës max. 60%.
 - e gjelbër brenda parcelës: -min.40%
- DISTANCA :
 - nga fqiu (kufiri I parcelës) ku ka hapje të kthinave primare (si psh qëndrim ditor, dhoma fjetjeje, kuzhina etj) , min.0.75h.
 - nga fqiu (kufiri I parcelës) ku ka hapje të kthinave sekondare (si psh. toalete, depo, shkallë etj) , min.0.25h.
 - nga fqiu (kufiri I parcelës) me marrëveshje- 0 m.
 - bodrumi mund të vendsoet nga fqiu (kufiri I parcelës) në distancë max prej 1.5 m ose 0 m me marrëveshje.
- VIJA NDËRTIMORE :
 - 7.5m (kur profili rrugor ka gjërësi prej 7-15 m')
 - 10.0 m (kur profili rrugor ka gjërësi mbi 15 m')

3.2 PËRMBAJTET JOBANIMORE

KUSHTET E VENDOSJES DHE TË PLANIFIKIMIT

Parcela ndërtimore duhet të ketë qasje në rrugë me gjërësi minimale 6.0 m'

Shkalla e shfrytëzueshmërisë së tokës është max. 30%

Vija e rregullimit është e përcaktuar në raport me vijën e trasesë rrugore.

Vija ndërtimore është përcaktuar në raport me vijën e rregullimit. Varësisht prej kategorisë së rrugës vija ndërtimore është në distancë prej 7.5-10 m'.

Lejohet ndërtimi i gardhit vetëm për kufizim të parcelës së çerdhes së fëmijëve dhe të shkollës.

Parkimi për vetura duhet të sigurohet brenda parcelave sipas normativave të përshkruara në tërësitë hapësinore dhe blloqet (shih. 3.7 Rikapitullim-kushtet urbanistike)

3.2.1 INSTITUCIONET ARSIMORE

3.2.1.1 Qerdhe/Kopshtet

Qerdhja në tërësinë 'PARKU'

Sip.e parcelës =30.9 ari

Është e kufizuar me dy rrugë të niveleve pothuajse të njëjta: rrugën në anën verilindore e cila e ndan me ndërtesën e komunës dhe rrugën në anën juglindore e cila e ndan me zonën e varrezave dhe njëherit paraqet rrugën për qasje në shkollë. Për shkak të orientimit të ndërtesës së qerdhes (kërkesa juglindje për dhomat e fëmijëve) preferohet që qasja kryesore në qerdhe të bëhet nga rruga verilindore, në mënyrë që juglindja të mbetet e lirë për funksionet kryesore dhe për oborr. Meqenëse në afërsi të qerdhes është e planifikuar edhe shkolla plani rekomandon punimin e projektit për të dy ndërtesat ose për tërë bllokun.

Qerdhja në tërësinë 'QENDRA'

Sip.e parcelës=28.7 ari

Është e kufizuar me dy nivele të rrugës. Qasja në ndërtesë duhet të bëhet nga rruga sekondare (respektivisht nga rruga në pjesën veriore) duke e lënë kështu mundësinë e orientimit të dhomave kah ana juglindore të cilat njëherit edhe izoloohen nga gjelbrimi izolues. Parkimi mund të jetë përgjatë rrugës me një shmangje prej 1m ndaj shiritit të gjelbërimit.

Qerdhja në tërësinë 'FSHATI'

Sip.e parcelës=25.6 ari

Është e vendosur parballë shkollës së planifikuar në pjesën e sipërme. Kufizohet më vetëm një

rrugë. Për shkak se rruga ka formën harkore dhe është në pjerrësi , qasja në ndërtesë mund të nga pjesa e veriore duke siguruar kështu orientim adekuat për funksionet themelore të qerdhes.

Qerdhja në tërësinë 'PRERIJA'

Sip.e parcelës=30.0 ari

Kufizohet më dy rrugë të niveleve të ndryshme: rrugën përmbledhëse në anën lindore dhe rrugë banimi në anën juglindore. Gjatë punimi të projektit urb-arkitektonik duhet pasur parasysh qasjen në ndërtesë në raport me vendndaljen e autobusit (I cili është I paraparë përgjatë rrugës përmbledhëse) si dhe orientimit të hapësirave kryesore të ndërtesës si dhe oborrit

Qerdhja në tërësinë 'VERANDA'- në kuadër të ndërtesës shumëbanesore

Sipërfaqja e qerdhes në kuadër të ndërtesës shumëbanesore është min 600 m², ndërsa sipërfaqja e gjithëmbarshme bashkë me oborr është 19.8 ari.

Sipërfaqja e parcelës së kësaj qerdhe është më e vogël për shkak se kemi rastin e kombinimi të banimit me institucion arsimor. Hapësira e qerdhe kopshtit është vendosur në përdhesë ndërsa në katet në vazhdim mund të zhvillohet banimi. Këtë e kufizojnë dy rrugë të niveleve të njëta – në pjesën e sipërme dhe të poshtme, të cilat rrugë mundësojnë qasjen në ndërtesë nga dy nivele të ndryshme +0.0 dhe -11.0m. Qasja kryesore në ndërtesë duhet të jetë nga rruga e cila e kufizon ndërtesën nga ana e sipërme, në mënyrë që dhomat dhe oborri të jetë I orinetuar kah juglindja. Për shkak të nivelit të rrugës , parkingjet preferohen të jenë përgjatë rrugës.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR QERDHE/KOPSHTE:

- SIPËRFAQJA :
 - e shfrytëzuar brenda parcelës- max. 30 %
 - e bodrumit brenda parcelës max. 60%.
 - e gjelbër brenda parcelës: -min.40%
- NUMRI I FËMIJËVE
 - Për qerdhet e pavarura- (100 fëmijë) 25m²/fëmijë respektivisht 25 ari
 - Për qerdhen në kuadër të ndërtesës- min 600 m² (10 grupe në min 6 dhoma).
- KATËSIA/LARTËSIA:
 - P+1
 - Në përdhesë (tek qerdhja në kuadër të ndërtesës)
 - Lartësia e pastër e dhomave min 3.0m
- PARKIMI:
 - 1 vendparkim/1 punëtor dhe 1 vendparkim/10 fëmijë
 - 10 vendparkime për staf, për prindër mund të shfrytëzohen edhe ai I banimit
- VIJA NDËRTIMORE:
 - 7.5m (kur profili rrugor ka gjërësi prej 7-15 m')
 - 10.0 m (kur profili rrugor ka gjërësi mbi 15 m')

Të gjitha qerdhet duhet të rrethohen me gjelbërim të lartë.

3.2.1.2 Shkolla fillore dhe e mesme e ultë

Shkolla fillore në zonën e poshtme ka sipërfaqe $S=91.87$ ari dhe është pjesë e kompleksit të qerdhes dhe parkut të lagjes.

Shkolla fillore në zonën e sipërme si e domosdoshme në këtë pjesë ka sipërfaqe prej $S=79.55$ ari. E vendosur në mes të banimit ka qasje nga dy rrugë sekondare.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SHKOLLA:

- SIPËRFAQJA :
 - e shfrytëzuar brenda parcelës- max. 30 %
 - e bodrumit brenda parcelës max. 60%.
 - e gjelbër brenda parcelës: -min.40%
- NUMRI I NXËNËSVE
 - 480-720 (varësisht nga numri I nxënësve në klasë 24 apo max 36 nxënës)
- KATËSIA/LARTËSIA:
 - P+2
- PARKIMI:
 - 1 vendparkim/1 punëtor dhe 1 vendparkim/40 nxënës(prindër)
- VIJA NDËRTIMORE:
 - 7.5m (kur profili rrugor ka gjërësi prej 7-15 m')
 - 10.0 m (kur profili rrugor ka gjërësi mbi 15 m')

3.2.2. INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

3.2.2.1 Qendra e mjekësisë familjare

Është e vendosur përgjatë rrugës kryesore në një sipërfaqe prej 14.23 ari. Etazhiteti maksimal I QMF-së është P+1.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR QMF-në:

- SIPËRFAQJA :
 - e shfrytëzuar brenda parcelës- max. 30 %
 - e bodrumit brenda parcelës max. 60%.
 - e gjelbër brenda parcelës: -min.40%
- KATËSIA/LARTËSIA:
 - P+1
- PARKIMI:
 - 1 vendparkim/1 punëtor dhe 10 vendparkingje për banorë
- VIJA NDËRTIMORE:
 - 7.5m

3.2.3. NDËRTESAT TJERA PËR SHËRBIME PUBLIKE

3.2.3.1 Qendra e sigurisë

Është e planifikuar përgjatë arteries kryesore "A.Krasniqi" duke I përmbushur kështu standardet lidhur me qasjen nga nivele të ndryshme rrugore . Qendra e sigurisë e cila përfshinë në vete stacionin policor dhe të zjarrëfikësve është planifikuar në sipërfaqe prej 28.8 ari.

Stacioni policor-duhet të përmbajë hyrjen publike e cila mund të shërbejë edhe për staf si dhe në veçanti hyrjen interne apo zonën e sigurisë. Hyrja kryesore duhet të jetë nga rruga kryesore së bashku me parkingjet. Preferohet ndarja e hyrjes për publik dhe staf. Hyrja interne e cila shërben për transferin e të burgosurit duhet të jetë në anën e kundërt ndaj hyrjeve tjera. Qasja e automjeteve të policisë të bëhet nga rruga kryesore. Parkingu duhet të ofrojë mundësinë e lëvizjes dhe parkimit të automjeteve të ndryshme policore.

Stacioni I zjarrëfikësve - për operim funksional ndërtesa duhet të ketë mundësi qasjeje nga dy rrugë të ndryshme. Ndërtesa duhet të përmbajë tri njësi themelore: stacionin e zjarrëfikësve, administratën dhe dhomën e aparateve. Dhoma e aparateve duhet të jetë e pozicionuar në atë mënyrë që të ketë mundësi qasjeje nga dy anë, mundësisht nga rrugë të niveleve të ndryshme. Ndërtesa duhet të përmbajë: parkingun për vetura dhe kamionë si dhe "buffer" zonën apo zonën izoluese me gjelbërim të lartë ndaj ndërtesave në afërsi të saj.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR QENDRËN E SIGURISË:

- SIPËRFAQJA :
 - e shfrytëzuar brenda parcelës- max. 30 %
 - e bodrumit brenda parcelës max. 60%.
 - e gjelbër brenda parcelës: -min.40%
- KATËSIA/LARTËSIA:
 - P+1
- PARKIMI:
 - 1 vendparkim/1 punëtor dhe 4 vendparkingje për kamionë dhe vetura të policisë
- VIJA NDËRTIMORE:
 - 7.5m

3.2.4 NDËRTESAT PËR KULTURË, SPORT DHE REKREIM

3.2.4.1 Qendra e komunitetit

Bazuar në standardin e dhënë në PZHU⁶, në lagjen arbëria 3 janë paraparë tri qendra të komunitetit. Këto qendra janë paraparë në kuadër të ndërtesave të banimit (e preferueshme kati përdhese dhe kati I parë) dhe atë në tërësi : Veranda, Qendra dhe Prerija.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR QENDRËN E KOMUNITETIT:

⁶ Plani Zhvillimor urban I Prishtinës 2012-2022. KK Prishtina, Hidroing DK, Urbanistica (2013). Fq 183

- SIPËRFAQJA :
 - 0.5 m² /banorë (1QK/5000 banorë)
- KATËSIA/LARTËSIA:
 - Në përdhesë
 - Lartësia e pastër e hapësirave min 4.0m
- VIJA NDËRTIMORE:
 - E përcaktuar në bazë të bllokut përkatës.

3.2.4.2 Ndërtesat e sportit dhe rekreimit

Janë të planifikuara në sipërfaqen e lirë të parkut prej 2.46 ha. Ndërtesat e sportit (fitnes, wellness center dhe të ngjajshme) bashkë me përmbajtjet përcjellëse si psh. restoran, kafene, market dhe ndonjë shitore sporti, duhet të jenë në funksion të natyrës. Arkitektët gjatë dizajnit duhet t'ua konsiderojnë natyrën si atraksion primar ndërsa ndërtesat të jenë të shkrira në gjelbërim. Etazhiteti maksimal duhet të jetë P+1, ndërsa raporti në mes të sipërfaqes së ndërtuar dhe të pandërtuar është 20%-80%.

Inkurajohet përdorimi i kulmeve të gjelbërta dhe forma të cilat shkrihen në peizazh.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR NDËRTE SAT E SPORTIT DHE REKREIMIT:

- SIPËRFAQJA :
 - e shfrytëzuar brenda parcelës- max. 20 %
 - e bodrumit brenda parcelës max. 60%.
 - e gjelbër brenda parcelës: -min.60%
- KATËSIA/LARTËSIA:
 - P+1
- PARKIMI:
 - Hapësira për parkim të 1 veture dhe 2 bicikletave çdo 200-300 m² të lokacionit
- VIJA NDËRTIMORE:
 - 10.0 m (ana veriore - rruga "A.Krasnqi")
 - 20 m (ana JP- rruga nacionale)
 - 30 m (ana JL- gjelbërimi izolues kah Ambasada e SHBA-ve)

3.2.5 NDËRTE SAT ADMINISTRATIVE

Në lokacionin ekzistues në të cilën gjendet ndërtesa e Komunës edhe me PZHU është paraparë po I njëjti destinim. Në rast se në të ardhmen do të ndërtohet ndonjë ndërtesë e re e administratës atëherë kushtet do të jenë si këto të prezentuara më poshtë:

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR NDËRTE SËN E ADMINISTRATËS:

- SIPËRFAQJA :
 - e shfrytëzuar brenda parcelës- max. 30 %
 - e bodrumit brenda parcelës max. 60%.

- e gjelbër brenda parcelës: -min.40%
- KATËSIA:
 - P+4
- PARKIMI:
 - Sipas llojit të ndërtesës
- VIJA NDËRTIMORE:
 - 7.5m (ana juglindore- kah ndërtesa e komunës)
 - 10.0 m (ana verilindore dhe jugperëndimore - rruga "A.Krasnqi")

3.2.5 NDËRTESTAT ME DESTINIM TË VEÇANTË

3.2.5.1 Ambasada E SHBA-ve

Përcaktimi i lokacionit për Ambasadën e SHBA-së është dhënë me pëlqim paraprak, prandaj kriteret për shfrytëzim janë dhënë bazuar në këtë pëlqim.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR AMABASADËN E SHBA-së:

- SIPËRFAQJA :
 - e shfrytëzuar brenda parcelës- max. 55 %
 - e gjelbër brenda parcelës: -min.45%
- KATËSIA:
 - P+4
- PARKIMI:
 - Sipas projektit
- VIJA NDËRTIMORE:
 - 7.5m, 10m dhe 20 m

3.3 INFRASTRUKTURA RRUGORE DHE TRAFIKU

Rrjeti rrugor është propozuar duke u bazuar në rrjetin ekzistues rrugor si dhe pjesërisht në propozimet e bëra në planet tjera si PZHU dhe PRRU. Sipas këtij propozimi rrjeti rrugor nuk pëson ndryshime të mëdha të cilat do të ndikonin esencialisht në plan. Një ndër qëllimet sipas PZHU-së është shfrytëzimi i rrugës "Ahmet Krasniqi" si arterie kryesore. Edhe gjatë rishikimit kjo rrugë mban po këtë funksion dhe parashihet si rrugë edhe për këmbësorë dhe biçiklistë e cila është pjesë e rrjetit të gjelbër të lagjes.

Zona e poshtme e lagjes, e cila gjatë fazës së analizave është konsideruar si zona më problematike meqë kanë munguar qasjet për ndërtesat pranë hekurudhës, është zgjidhur përmes futjes së një rruge për qasje. Kjo rrugë për qasje shtrihet paralel me unazën e brendshme dhe mundëson qasje për të gjitha ndërtesat që shtrihen përgjatë hekurudhës dhe gjithashtu ndihmon në krijimin e një lëvizje më të lirë të zonës së poshtme (shih. Hartën 'Rrjeti rrugor')

Rrugët e nivelit të ultë janë bazuar në strukturën ekzistuese, përfshirë këtu rrugët ekzistuese të shtruara, rrugët e shkelura, shtigjet për këmbësorë si dhe korridoret e mundshme "të shpërthimit" duke mos cenuar/ rrënuar asnjë ndërtesë ekzistuese.

Rrugët e reja të planifikuara të cilat nuk e kanë pasur për bazë ndonjë rrugë ekzistuese apo korridor të mundshëm shpërthimi, janë planifikuar duke u bazuar në kufinj të dhe format e parcelave. Është përcjellur parimi që aksi rrugor të jetë kufiri i një parcele, në mënyrë që rruga e planifikuar të kalojë nëpër secilën pronë në mënyrë të barabartë.

Prandaj është synuar që:

- Të ruhen dhe shfrytëzohen trasetë ekzistuese të rrugëve
- Të ruhen dhe shfrytëzohen sa më shumë profilet ekzistuese rrugore
- Të propozohen trase të reja rrugore të cilat cenojnë minimalisht ndërtesat ekzistuese
- Të propozohen trase të reja rrugore të cilat kontribuojnë në qasje më të lehtë dhe më të depërtueshme brenda lagjes.



Harta 4 Rrjeti rrugor-hierarkia

3.3.1 KATEGORIZIMI I RRUGËVE

Lagja "Arbëria 3" kufizohet më rrugë të niveleve të ndryshme: magjstralën Shkup-Mitrovicë (M2), dhe unazën e brendshme përgjatë së cilës kalon hekurudha Prishtinë-Beograd, dy rrugë kryesore në nivel të qytetit.

Sipas destinimit dhe rëndësisë, rrugët janë ndarë në këto kategori:

- Rrugë nacionale
- Unaza qendrore
- Rrugë kryesore urbane (rrugë urbane arteriale)
- Rrugë përmbledhëse
- Rrugë banimi




Fig 7. Rruga kryesore urbane "Ahmet Krasniqi"- segmenti I bulevardit




Fig 8. Rruga kryesore urbane "Ahmet Krasniqi".

3.3.1.1 Hekurudha

Në PRRU janë prezentuar binarët ekzsitues. Propozimi I rrugës paralele bashkë me unazën nuk e cënon hapësirën e binarëve. Në bazë të kërkesës nga zyrtarët e hekurudhave është lënë distance prej 3.5 m nga binar I fundit si dhe një shirit I sigurisë prej 1.2 m. (shih fig.9)

3.3.1.2 Treni urban

Korridorin I dhënë sipas PZHU-së për trenin urban nuk e prek kufirin e caktuar për trajtim të planit rregullues. Meqenëse në PZHU nuk janë dhënë detaje lidhur me dimensionet dhe tipin e trenit urban, ka mbetur që komuna së bashku me hartuesit e planit rregullues Lakrishte t'a detalizojnë dhe përcaktojnë qartë vendin e tij.

3.3.1.3. Unaza qendrore

Një nga pikat e detyrës projektuese është : *"plotësimi i trafikut dhe infrastrukturës me projektet e hartuara dhe ato që janë në procesin e implementimit përmes bartjes në planin e reviduar dhe inkorporimi me rrjetin e ri të rrugëve"* dhe *"plotësimi i gjendjes faktike më lejet e lëshuara deri më tani dhe të objekteve të legalizuara"*. Gjatë mbishtresimit, sjelljes në koordinata dhe analizimit të projekteve për të cilat janë dhënë lejet si dhe projekteve kryesore të rrugëve janë vërejtur shumë mospërputhje dhe gabime. Problemet qëndrojnë kryesisht në joharmonizimin e zgjidhjeve detale urbanistike në raport me projektet detale të rrugëve. Një nga problemet kryesore është projekti I kryesor I unazës qendrore.

Projekti kryesor I unazës qendrore ka një profil rrugor I cili nuk mundëson qasjen në pjesën e poshtme të lagjes respektivisht në ndërtesat përgjatë hekurudhës, përderisa të gjitha ndërtesat me plan e kanë qasjen kryesore nga unaza. Meqenëse të gjitha projektet detale përgjatë hekurudhës janë punuar në princip të tillë si dhe duke e parë unaza qendrore paraqitet si një barrier duke e izoluar edhe në një shkallë tjetër lagjen, si autorë kemi propozuar ndryshim të funksioneve brenda profilit të unazës. Kjo njëherit e zgjidh edhe problemin me hekurudhën.

Zgjidhja bazohet brenda korridorit të paraparë me projekt kryesor të unazës, por duke ia shtuar një rrugë paralele (2.5 m') përgjatë unazës e cila mundëson qasjen në ndërtesa si dhe njëherit shërben edhe për transport publik. Përgjatë kësaj rruge paralele është paraparë edhe shiriti I gjelbërimit (0.9 m), shtegu për biçiklistë (2.0 m) dhe trotuari (2.0 m). Gjithashtu unaza qendrore (7.0 m) bashkë me shtegun e sigurisë (1.2 m) largohet nga binarët e fundit në një distancë prej 3.5 m.⁷

⁷ Kërkesa e Hekudhave të Kosovës është largimi I unazës qendrore në një distancë prej 3.0m nga binari I fundit. Përshkak të pjerrësisë në disa vende distance është lënë 3.5 m.

3.3.2 Elementet e profilit tërthror të rrugës




Fig. 9 Profili I unazës qendrore bashkë me binarët dhe rrugën paralele




Fig 10. a) Rrugë kryesore urbane- profili rrugor pranë ndërtesës së Komunës- "C-C"; b) rrugë përmbledhëse- profil- rrugor afër zonës ekonomike, prerja "D-D"; c) rrugë përmbledhëse- profili rrugor afër MiniMax "E-E".




Fig 11. a) rrugë banimi "H-H"; b) rrugë banimi "F-F"; c) rrugë banimi "G-G"

3.3.3 Trafiku

3.3.3.1 Orientimi i trafikut

Komunikacioni duhet që të orientohet me sinjalizimin adekuat vertikal, me shenjat e njoftimit, paraudhëtregues, udhëtregues, udhëkryq etj.

Orientimi me kohë dhe i rregullt i pjesëmarrësve në trafik për destinacionin e tyre të fundit, zvogëlon tollovitë në trafik, zvogëlon numrin e automjeteve në destinacionet e gabuara dhe në përgjithësi e bënë rrjedhën e trafikut më të lehtë.

3.3.3.2 Kufizimi i shpejtësisë

Me ligjin e komunikacionit, kufizimi maksimal i shpejtësisë në vendbanim në Kosovë është 50 km/h. sipas kompetencave të MTPT apo Kuvendit Komunal, shpejtësia në vendbanim mund të jetë edhe më vogël apo më e madhe. Shpejtësia maksimale në rrugën kryesore mund të jetë deri në 40 km/h. Kufizimi i shpejtësisë në rrugët sekondare dhe terciare është 20 km/h.

3.3.3.3 Regjimi i lëvizjes së autobusëve dhe mjeteve të rënda

Në të gjitha rrugët sekondare dhe terciare (rrugë banimi, rrugë për qasje) ndalohet lëvizja e mjeteve të rënda mbi 5 t dhe i autobusëve. Qarkullimi i kamionëve të lehtë lejohet për qëllime të furnizimit ndërsa qarkullimi i autobusëve lejohet vetëm në rrugët e përcaktuara në plan- ato kryesore.

3.3.4 Transporti publik

Lëvizja e autobusëve lokal bazohet në rrjetin e transportit publik i cili është i përcaktuar në nivel

të qytetit.




Fig.12 Linjat e autobusëve⁸

Në plan janë paraparë pikat e ndaljes së autobusëve, duke u bazuar në skemën zyrtare të qarkullimit të autobusëve si dhe në standardet lidhur me distancën në mes të pikave të ndaljes. Standardi I përvetësuar është 400 m.




Fig.13. Vendndalja e autobusëve

⁸ <http://prishtinabuses.info/> (26 gusht 2013)

3.3.5 Trafiku i qetë

3.3.5.1 Biçiklistët

Lagja Arbëria 3 për nga karakteristikat topografike dallohet me dy tërësi: pjesa e sipërme e lagjes e cila ndahet me arterien kryesore (rruga "A.Krasniqi") ka terren më të rrafshët I përshtatshëm për bicikleta dhe pjesën e poshtme me terren të pjerrët. Koncepti I rrjetit të biçiklistëve është menduar ashtu që përgjatë rrugëve kryesore të cilat kanë korridor më të gjërë dhe zhvillohet komunikacion më I lartë janë menduar shiritat të veçantë për biçiklistë, ndërsa tek rrugët e kategorive tjera (kryesisht banimore) janë menduar të jenë në kuadër të rrugës. Gjërësia e shiritit për biçiklistë është përvetësuar 1.20 m.



Fig.14 Raporti mes rrugëve me shirit të veçantë për biçiklistë dhe shirit të integruar.

3.3.5.2 Lëvizja e këmbësorëve

Trotuaret për këmbësorë janë paraparë me gjërësi të mjaftueshme sipas standardeve duke filluar prej 1.8-3.0 m. Përgjatë rrugëve ku përdhësa është aktive trotuari është më I gjërë- 3.0 m.

Në udhëkryqet ku trajektorja e lëvizjes së këmbësorëve pritet me rrugën automobilistike, janë paraparë vendkalimet e shënuara për këmbësor, të pajisura me sinjalizim adekuat vertikal.

Pjesët e udhëkryqeve dhe vendeve ku këmbësorët e trupojnë rrugën automobilistike duhet të jenë të dukshme ditën, të mos kenë pengesë nga gjelbërimi apo ndërtesë tjetër përkaj rrugës, ndërsa natën ato pjesë duhet të jenë të ndriçuar ashtu që në çdo kohë këmbësori të jetë i dukshëm nga vozitësit të cilët qarkullojnë në atë pjesë të rrugës.

3.3.5.3 Nënkalimi dhe mbikalimet

Hakurudha është një nga barrierat kryesore të cilat për një kohë të gjatë ka bërë që lagja Arbëria 3 të mos jetë e lidhur me pjesën e poshtme respektivisht lagjen Lakrishte. Propozimi , përpos lidhjes fizike përmes rrugës e cila lidhet në rrethin ekzistues të Lakrishtes, parasheh edhe

mbikalimet dhe nënkalimin për këmbësorë. Përgjatë tërë vijës pranë hekurudhës janë paraparë 3 kyçje: një nënkalim i cili është paraparë tek stacioni i trenit i cili duhet të jetë i pasur me përmbajtje të cilat joshin këmbësorin për ecje si dhe dy mbi kalime në pjesët e skajshme. Mbikalimi i parë është planifikuar të jetë më afër shkollës. Vendi i saktë i mbikalimeve dhe nënkalimit mund të përcaktohet edhe më planet më detale të cilat komuna do t'i parasheh në të ardhmen.

3.3.6 Vendparkimet

Me zgjidhjet ideore për dhënie të lejes së lokacionit, për ndërtim të ndërtesave të banimit, të punës apo tjera duhet siguruar kërkesën për vende parkimi. Numri i vendparkingjeve është i specifikuar për secilin funksion në tabelat e rregullave urbane për blloqet e caktuara (shih. "Kushtet urbanistike për tërësitë dhe blloqet")

3.4 HAPËSIRAT E PANDËRTUARA

3.4.1 Sipërfaqet e gjelbra

Me qëllim të arritjes së numrit optimal të drunjëve, duhet të mbillet së paku një dru me kurorë të gjerë për 250 m² të sipërfaqes së pandërtuar të zonës.

Trupat ekzistues të drurëve të ruhen. Nëse një numër i caktuar duhet të prehen për shkak të ndërtimit, atëherë ato duhet të zëvendësohen me drunj të rinj të mbjellur në pjesën e lirë të parcelës.

Sugjerohet mbjellja e bimëve autoktone, që i përshtaten klimës dhe vendit.

Sipërfaqet e gjelbra

Tek banimi i ultë minimum 50% e sipërfaqes së lirë duhet të jetë gjelbërim, ndërsa tek banimi i mesëm minimum 40 % e sipërfaqes së lirë.

Rregullimi i hapësirave të gjelbra duhet të bëhet në mënyrë që të përparojë karakteristikat funksionale dhe vizuale të rrugës.

Gjatë dizajnit të blloqeve të banimit përpos gjelbërimit në kuadër të ndërtesës kujdes duhet t'i shtohet edhe gjelbrimit të bllokut apo tërësisë. Prandaj arkitektët duhet që në dizajnin e tyre t'a bëjnë integrimin e tij me rrjetin e gjelbër që lidhin tërësi tjera. Rrjeti i gjelbër parasheh gjelbërim të lartë.

Sipërfaqet e gjelbra në profilin e rrugës

Duhet përdorur gjelbërim që i reziston nivelit të lartë të ndotjes. Duhet kontrolluar lartësinë dhe kurorën e tyre në mënyrë që të mos pengohet trafiku.

Drunjtë e rrugëve duhet të:

- sigurojnë definimin e profilit

- të jenë rezistent ndaj ndotjes dhe pluhurit (me gjethe të mëdha)
- të mos lëshojnë fruta ose rënie të degëve
- të mos pengojnë shikueshmërinë

3.4.2 Hapësira e lirë publike

Hapësira e lirë publike është klasifikuar në bazë të Indikatorëve të Përbashkët Evropian -ECI- (European Common Indicators).

3.4.2.1 Parku i lagjes-parku i Prishtinës

Paraqet një park publik ose hapësirë të hapur për shfrytëzim nga këmbësorët ose biçiklistët (këtu përfshihen edhe hapësirat e pllakosura për aktivitete në të hapur).

Kjo zonë ka karakterin e kompleksit të rekreimit jo vetëm për banorët e lagjes por për tërë qytetarët e Prishtinës. Sipërfaqja është e destinuar për sport, rekreim, argëtim formal dhe joformal dhe në të përfshihen sipërfaqe të gjelbëruara dhe ndërtesa për sport dhe rekreim. Përveç përmbajteve në të mbyllur për sport këtu bëjnë pjesë edhe shtigjet për këmbësorë, çiklizëm etj. Zhvillimii kësaj zone do të bëhet në funksion të pyllëzimit dhe rekreimit joformal. Kushtet për ndërtesat në brendi të parkut janë të dhëna në kapitullin 3.3 "Përmbajtjet jobanimore".

3.4.2.2 Hapësirat e gjelbërta në kuadër të banimit

Në kuadër të çdo blloku ta banimit duhet të parashihen terrenet e hapura për sport dhe rekreim. Këto hapësira gjithashtu duhet të jenë pjesë përbërëse e rrjetit të gjelbër të lagjes në tërësi. Në hapësirën e sportit dhe rekreacionit duhet të ketë përmbajtje për lojë të fëmijëve si dhe fusha për sport duke u bazuar në nevojat e banorëve dhe në përshtatshmëritë me lokacionin. Përveç fushës së lojës në kuadër të këtyre hapësirave mund të ketë sipërfaqe të pllakosura të cilat e luajnë rolin e shesheve apo pikave të takimit të banorëve të një kompleksi.

3.4.2.3 Rrjeti i arterieve të gjelbërta të lagjes

Tërë lagjen e Arbërisë 3 e ngërthen rrjeti i gjelbër i cili përpos që lidh tërësitë e lagjes në mes veti , ai njëherit mundëson sigurimin e sipërfaqeve për rekreim dhe sport për banorët e lagjes. Ky rrjet i gjelbër gjithashtu luan edhe rolin e krijimi të mikroklimave në kuadër të lagjes, prandaj karakteristikë e këtij rrjeti është dendësimi me gjelbërim të lartë. Rrjeti i gjelbër gjithashtu zbut raportin në mes të sipërfaqes së ndërtuar dhe asaj të pandërtuar, e cila konsiderohet s një ndër problemet të cilat lidhen me sigurimin e parqeve në kuadër të blloqeve të banimit.

Kushtet themelore tek këto korridore gjelbrimi janë: mbjellja e gjelbrimit të lartë, planifikimi i shtigjeve si dhe në raste ku është e mundur edhe ndonjë fushë e lojës.

3.4.2.4 Gjelbrimi izolues

Në lagjen Arbëria 3, gjelbërimi izolues është i planifikuar për disa arsye:

- izolimin e ndërtesave me destinim të veçantë- siguria e zonës së planifikuar për Ambasadën e SHBA-ve, përmes shiritit të gjelbrimit në gjërësi prej 30 m.
- mbrojtjen nga trafiku- mbrojtjen nga zhurma dhe smogu për ndërtesat kolektive përgjatë hekurudhës.
- mbrojtjen dhe izolimin e zonës së varrezave- për izolim vizual në pjesën veriperëndimore dhe për shkaqe mjedisore në pjesën jugperëndimore.

3.4.2.5 Varrezat

Hapësira e varrezave duhet të konzervohet dhe të shëndrrohet në park. Në të janë parashikuar: shtigjet për këmbësorë, parkingjet, qasja me rrugë, gjelbrimi izolues rreth parcelës së varrezave. Me plan është mundësuar qasja nga dy pika të ndryshme (sipas kërkesës së komunës bërë nga përfaqësuesit e dy konfesioneve).

Komuna duhet të shpall konkurs për ridizajnim të varrezave duke e shëndrruar atë në park si dhe të sigurojë lokacion tjetër për varrezat e reja.



Harta 5. Hapësirat e gjelbërta

3.5 MBROJTJA E MJEDISIT

3.5.1 Mbrojtja e ajrit

Qëllimi i mbrojtjes së ajrit nga ndotja është ruajtja e shëndetit të njerëzve, botës bimore dhe shtazore prandaj duhet aplikohet përcjellja e cilësisë së ajrit në lokacion. Kjo më së miri mund të menaxhohet nga qyteti përmes politikave për mbrojtjen e mjedisit.

Sa i përket ndikimit të trafikut është tentuar të arrihet një zgjidhje që ndikon në zvogëlimin e lirimit të gazërave të dëmshëm për ambient përmes planifikimit të rrjetit të trafikut (izolimi i pjesës së banimit përgjatë rrugës, hekurudhës, përmes shiritit të gjelbërimit në gjërësi prej 7.5m-10.0m me 2 drurende të shmangura), vendeve për parkim, qasjes së lehtësuar dhe zgjerimit të zonave për këmbësorë.

Në përmirësimin e kushteve higjienike, d.m.th. pastërtinë e ajrit dhe tokës ndikon edhe mirëmbajtja e rregullt e hapësirës.

3.5.2 Mbrojtja nga zhurma

Zonat e parapara për veprimtari me destinim pune në kuadër të banimit , niveli i lejuar i zhurmës mund të jetë derinë 55 db ditën, ndërsa natën deri në 45 db. R. Tek rrugët përbledhëse ku niveli i trafikut është më i lartë , janë propozuar rende drunjesh me qëllim të zbutjes së nivelit të zhurmës, ndërsa tek zona përgjatë hekurudhës drurend i dyfishtë (varësisht nga mundësia e realizimit, meqë distanca minimale e ndërtesës ekzistuese është 7.5 m).

3.5.3 Mbrojtja nga zjarri

Kushtet për ndërtesat , ku ato fqinje duhet të jenë më së paku 4.0m larg njëra-tjetrës, ose të ndara me mure mbrojtëse nga zjarri me kohëzgjatje min. 90 min.

Me qëllim të shpëtimit të njerëzve nga zjarri duhet që të gjitha ndërtesat të kenë mundësinë e qasjes nga veturat e zjarrëfikseve. Me këtë qëllim janë planifikuar edhe hidrantë (shih kapitullin "infrastruktura teknike"). Gjatë procesit të aplikimit për ndërtim, ndërtuesit duhet të detyrohen që të planifikojnë ndriçimin emergjent, pastaj të pengohet parkimi në vendet ku janë paraparë hidrantët. Gjithashtu me planet e nivelit më të ultë të zgjidhen depërtimet për zjarrëfikës, dhe sa më shumë të evitohen blloqet e mbyllura.

3.5.4 Trajtimi i mbeturinave

Plani për menaxhimin e mbeturinave është hartuar në nivel të qytetit dhe duhet të përfshijë edhe zonat të planifikuara për zhvillim. Nëpër lokacion duhet përcaktuar shumë pika për deponimin e mbeturinave në kontenjerë. Këto hapësira për veç që duhet pasur qasje të lehtë nga rruga, ato gjithashtu duhet të jenë vizuelisht të izoluara (preferohet me tampon gjelbërimi, por edhe me gardh apo të ngjajshme). Këto hapësira nuk duhet të pengojnë lëvizjen e lirë të këmbësorëve por edhe të veturave. Gjithashtu duhet përdorur kontenjerë në të cilat ka mundësi të bëhet selektimi i mbeturinave.

Materiali ndërtimor I hedhur pas rrënimit të ndërtesave, përveç atij që përmban bitumen, duhet shfrytëzuar si material për sanim të deponive të mbeturinave.

3.5.5 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis

NDIKIMI I PRRU-SË NË PROJEKTET KRYESORE

Plani rregullues I reviduar luan rol të madh në zbatimin e projekteve kryesore të cilat janë rrjedhë e tij. Shfrytëzimi I tokës, gjërësitë e korridoreve rrugore, shfrytëzueshmëria e tokës, vija rregulluese dhe ndërtimore, lartësia, janë kushte të cilat bëjnë që projektet të mos tejkalojnë kufizimet dhe mundësitë që jep PRRU-ja si një dokument strategjik I planifikimit.

ASPEKTET KRYESORE TË GJENDJES EKZISTUESE MJEDISORE

Ndikimet e mundshme të zhvillimit të PRRU-së mund të vlerësohen nga ndryshimet e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e planit përmes indikatorëve ekzistues, të supozuar cilësorë dhe sasiorë. Sipas kërkesave të daluara nga Direktiva e VSM-së, gjendja mjedisore në lagjen Arbëria 3 karakterizohet nga këta receptorë mjedisorë:

- Popullsia dhe shëndeti publik
- Biodiversiteti
- Cilësia e ajrit
- Faktorët klimatik
- Peisazhi
- Infrastruktura fizike

Popullsia dhe shëndeti publik- Në lagjen Arbëria 3 momentalsiht jetojnë afër 5500 banorë në një sipërfaqe prej 87 ha, me dendësi banore prej 64ban/ha. Sipas PRRU-së numri I banorëve rritet në ~16000 banorë që I bie në një dendësi prej 183 ban/ha. Zona më e dendësuar me ndërtim është pjesa e poshtme e lagjes, respektivisht tërësia "Veranda". Kjo hapësirë për nga funksioni është banim I përzier por pa rregullim të hapësirës së lirë publike gjë që e vë në presion banimin dhe shëndetin në përgjithësi.

Për këtë arsye përvetësimi I koeficientëve minimal, të ndërtueshmërisë në të mirën e hapësirës së lirë , në PRRU ruan parametrat e pranueshmë kryesor mjedisorë.

Janë disa çështje që janë të lidhura me shëndetin publik në përgjithësi:

- Planifikimi I transportit publik që ndikon në uljen e emetimit të gazërave dhe zhurmës
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi I cili është mbështetur në shpërndarjen adekuate të përmbajtjeve përcjellëse të banimit
- Rapoti në mes të sipërfaqes së gjelbër dhe asaj të ndërtuar (30%- 70%)
- Parqet dhe sipërfaqet tjera të gjelbërta
- Ndërtimit I rjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik dhe trajtimi I ujërave të zeza.
- Menaxhimi I mbeturinave.

VEÇORITË KRYESORE NATYRORE TË LAGJES ARBËRIA 3

Lagja Arbëria 3 nuk karakterizohet me ndonje veçanti natyrore të theksuar. Prezenca e lokacionit të varrezave konsiderohet si një potencial në krijimin e një parku si dhe hapësira erosive rreth saj në pyllëzim. Gjithashtu

hapësira e dedikuar për sport dhe rekreim, parqet dhe hapësirat e gjelbërta në kuadër të blloqeve të banimit të mesëm dhe lartë mund të konsiderohen zona të cilat mund të kenë ndikime të theksuara mjedisore.

Më poshtë janë prezentuar kategoritë kryesore të shfrytëzimit të tokës për të parë raportin e sipërfaqes së ndërtuar dhe asaj të lirë:

			ha	%	ha	%
1	SIPËRFAQE E DEDIKUAR PËR BANIM	Sipërfaqe e ndërtuar	16.13	18.53	53.75	61.75
		Sipërfaqe e lirë	37.63	43.23		
2	SIPËRFAQE E LIRË				14.90	19.39
3	SIPËRFAQE PËR QARKULLIM	Sipërfaqe e ndërtuar	5.52	18.525	18.39	61.75
		Sipërfaqe e gjelbëruar	12.87	21.13		

Tab 10. Sipërfaqja e lirë në raport me kategoritë kryesore të shfrytëzimit të tokës

SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE PEIZAZHI

Çështje mjedisore që lidhen me shfrytëzimin e tokës janë:

- Shfrytëzimi i tokës për ndërtim është në rënje çka do të thotë që raporti 30%/70% është në favor të sipërfaqes së lirë respektivisht 50% të sipërfaqes së gjelbër.
- Planifikimi i sipërfaqeve për ndërtim nuk cenon hapësirat e lira të gjelbërta (psh varrezat, hapësira për sport dhe rekreim).

Rrëzimet natyrore në mjedisin fizik - momentalisht (në kohën kur është bërë revidimi) është duke u hartuar projekti lidhur me kushtet teknike inxhinierike të pjesës së poshtme të lagjes , prandaj çdo konkluzion do të rrjedh nga kjo analizë.

NDIKIMET NË AJËR- Rruga nacionale, unaza qendrore dhe arteria kryesore e lagjes (rruga "A.Krasniqi") mund të konsiderohen si ndotës të ajrit si dhe do të ndikojnë në rritjen e nivelit të zhurmës. Masat e parashikuara me plan si: shtimi i shiritit të gjelbërimit në profilet rrugore, transporti publik, gjelbërimi izolues , shtimi i një shiriti të gjelbërimiti në profilin e unazës qendrore e cila shtrihet paralelisht me hekurudhën, planifikimi i elementeve mbotjës ndaj zhurmës përgjatë unazës qendrore, planifikimi i rrjetit elektrik i cili shmang përdorimin e gjeneratorëve , do të ndikojnë në uljen e nivelit të zhurmës dhe ndorjes së ajrit krahasuar me vlerat aktuale.




Fig.15 a) Zonat me ndikim të mundshëm të ndotjes b) mundësia e uljes së nivelit të ndotjes përmes planifikimit

Parime tjera që ndikojnë në mjedis janë:

- Krijimi I parqeve të reja të blloqeve urbane
- Krijimi I korridoreve ekologjike (psh bulevardi)
- Respektimi I Indeksit të sipërfaqes së gjelbër (ISGJ)
- Rregullimi I oborreve (kopshteve) në shtëpitë e banimit
- Gjelbërimi me drunjë dhe shkurre dekorative përgjatë trotuareve dhe hapësirave publike dhe gjysëmpublike
- Planifikimi I transportit publik
- Planifikimi I një rrjeti të trafikut modern
- Përmirësimi I gjendjes së rrugëve ekzistuese dhe zgjerimi I tyre sipas mundësisë
- Përmirësimi I profileve ekzistuese rrugore duke shtuar shiritin për bicikleta
- Sigurimi I qasjeve në rrugë sipas standardeve
- Ndriçimi I rrugëve
- Planifikimi I rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik

3.6 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

3.6.1. Rrjeti i ujësjellësit

Propozimi lidhur me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit përbëhet prej 4 komponenteve kryesre:

- koncepti teknik I furnizimit me ujë, largimit të ujërave fekal dhe atmosferik nga lagja në fjalë për rastin e popullimit të tërësishëm të lagjes
- dimensionimi optimal i gypave të ujësjellësit, kanalizimit fekal dhe atmosferik
- shfrytëzimi I recipientëve të mundshëm që mundësojnë transport efikas të ujërave nga kolektori
- kompletimi I projekti me dokumentacion teknik.

Të dhënat për projektim:

Për përpilimin e këtij dokumentacioni teknik, janë marrë për bazë këto të dhëna:

- Zgjidhja urbanistike e lagjes
- Ndarja e lagjes sipas llojit të ndërtimit
- Të dhënat për ndarjet e lartshënuara
- Sipërfaqet nëpër ndarje dhe në tërësi
- Numri i përgjithshëm të banorëve
- Llojet e objekteve
- Sipërfaqet e objekteve
- Sipërfaqet e objekteve përcjellëse të banimit
- Sipërfaqet e gjelbëruara dhe për rekreacion
- Rrjetin e rrugëve
- Prezantimin vertikal dhe horizontal të sipërfaqeve për urbanizim

3.6.1 Rrjeti i kanalizimit

3.6.1.1 Rrjeti i kanalizimit atmosferik

Intensiteti i reshjeve - bazë për llogaritjen e intensitetit të reshjeve janë marrë të dhënat meteorologjike nga "Baza hidroekonomike e Kosovës", botimi 1982.

Të dhënat e shfrytëzuara në këtë projekt janë të dhënat e stacionit meteorologjik në Gjilan. Të dhënat janë për reshjet mesatare mujore për vargun e viteve 1948-1978. Vargu për llogari është 30 vjeçar që është meritore për përllogaritje.

Reshjet mesatare vjetore për këtë varg për qytetin e Prishtinës janë $i=598$ mm. Për llogaritjen e intensitetit janë marrë reshjet maksimale dy vjeçare me kohëzgjatje $t=25$ min.

Në bazë të këtyre të dhënave përpiluesit e këtij projekti kanë fituar prurjen meritore maksimale $q=120$ l/s/ha.

Koeficientet e rrjedhjes

Nga tabela e ndarjeve të blloqeve shihet se kemi disa lloje të ndërtimeve që në projektim konsistojnë me koeficient të ndryshëm të rrjedhjes.

Në bazë të normave në fuqi, në tabelën e mëposhtme janë dhënë koeficientet e rrjedhjes për llojet e ndërtimeve:

Lloji i ndërtimit	Koeficienti
Kulmi	0,90
Trolli	0,35
Gjelbërimi	0,18
Parku	0,15
Parkingu	0,50
Sipërfaqe e lirë	0,25
Fushë sporti	0,85
Rrugë	0,85

Në llojin e ndërtimit me kulme kanë hyrë të gjitha objektet e ndërtimit të lartë siç janë:

- Banimi i ulët
- Banimi i mesëm
- Afarizmi
- Çerdhe dhe kopshte
- Shkollat (mesme dhe fillore)
- Qendrat administrative etj

Në bazë të këtyre koeficienteve dhe sipërfaqeve përkatëse është bërë edhe llogaria e sasisë së ujit për dimensionimin e gypave.

Bazë themelore e shpërndarjes së rrjedhjes së ujit ka qenë pjesët e blloqeve si dhe topografia e terrenit.

- **Topografia e terrenit**

Terreni në përgjithësi mund të klasifikohet si i përshtatshëm për ndërtimin e kanalizimeve atmosferike. Pjerrësia e terrenit ka ndikuar në përzgjedhjen e trases pa ndonjë pengesë serioze topografike, dmth. nuk ekziston ndonjë rast me kundër rënje të theksuar.

Zgjidhja inxhinjerike

Topografia e terrenit ka kushtëzuar që ujërat e shiut të drejtohen nga lumi rruga e asfaltuar, gjegjësisht në drejtim të hekurudhës, prej nga ujërat do të shkarkohen në lumin e Prishtinës, kështu që projektuesi ka paraparë që të ketë tri pika shkarkuese në këtë lumë. Ndarja e tërë zonën në tri njësi është bërë që diametrat e gypave të jenë më të vegjël.

Llogaria hidraulike për dimensionin e gypave është bërë duke marrë për bazë reshjet në Prishtinë, mbulesën e sipërfaqes dhe madhësinë e sipërfaqes.

Në bazë të këtyre llogarive ka rrezultuar që gypi kryesor i zonën së dytë në të cilën shkarkohen ujërat e pjesës më të madhe të kësaj zone do të jetë me diametër DN1500mm, kurse gypi i zonën së parë është me diametër DN1000mm dhe e zonës së tretë është me diametër DN500mm.

- **Traseja e rrjetit të kanalizimit atmosferik**

Projektuesi ka shfrytëzuar rrjetin e rrugëve të lagjes për trasimin e rrjetit në fjalë.

Kanali do të kaloj mesit të rrugës dhe përcjellë pjerrësinë sipas projektit dhe sipërfaqes së rrugës.

Në të dy anët e kanalit ndërtohen ujëmbledhësit, gjegjësisht pusetat e shiut, në të cilët shkarkohen ujërat. Prej këtyre pusetave ujërat do të shkarkohen në kolektorin kryesor.

- **Ndarja e sistemit të kanalizimit atmosferik**

I gjithë rrjeti i kanalizimit atmosferik është me gjatësi L= 13.355 m.

-	Ø1500mm	L=285m
-	Ø1200mm	L=75m
-	Ø1000mm	L=605m
-	Ø 800mm	L=605m
-	Ø 630mm	L=615m
-	Ø 500mm	L=715m
-	Ø 400mm	L=2,860m
-	Ø 315mm	L=4,825m
-	Ø 250mm	L=2,770m

Pra, siç shihet diametrat e këtyre gypave janë nga D-250mm deri në D=1.500mm.

Niveleta e gypave duhet të përshtatet rënjes së terrenit.

Materiali i gypave është nga HDPE/8 të brinjëzuar.

Vërejtje: Në raste të caktuara, në bazë të llogarive hidraulike diametri i gypit është më i vogël se D-250 mm, projektuesi ka përvetësuar diametrin D_{min} -250mm, që është diametri minimal i lejuar nga rregullat dhe normat teknike në fuqi.

3.6.2.2 Rrjeti i kanalizimit fekal

Norma e harxhimit të ujit

Bazë për llogaritjen e sasisë meritore të ujërave sanitar ka qenë norma e harxhimit të ujit për njësi të shfrytëzuesit. Për llogaritje janë shfrytëzuar normat e lejuara sipas DIN-it, EC dhe dispozitave ligjore në fuqi. Sipas prej shfrytëzuesi të ujit, janë përvetësuar edhe normat përkatëse.

Norma e harxhimit për banorë është $q_n=200\text{l/d}$, koeficienti i jonëtrajtshmerisë ditore është $k_d=1.60$ ndërsa ai i jonëtrajtshmerisë se orës $k_h=2.0$. Në sasinë meritore të ujit për llogaritë hidraulike, gjegjësisht caktimin e dimensioneve të gypave, ndikim kanë pasur edhe sasinë e ujërave të pashfrytëzuara siç janë infiltrimi i ujit në kanal si dhe pastrimi i gypsjellësit. Shuma e të gjitha këtyre ka qenë meritore për dimensionimin optimal të gypave.

Për informata më të hollësishme shiko analizën e harxhimit të ujit.

Shfrytëzuesi	Norma
Banorët	200 l/d
Afarizmi	5,0 l/m ² /d
Çerdhet, shkollat	8,0 l/nx./d
Biblioteka, teatri, muzeu	5,0 l/viz/d

- Topografia e terrenit

Terreni në përgjithësi mund të klasifikohet si i përshtatshëm për ndërtimin e kanalizimeve fekale. Pjerrësia e terrenit ka ndikuar në përzgjedhjen e trases pa ndonjë pengesë serioze topografike, dmth. nuk ekziston ndonjë rast me kundër rënje të theksuar dhe si i tillë ka ofruar në zgjidhje optimale inxhinjrike pa shfrytëzuar në sanë pikë të rrjetit pompa për ngritje të ujit në lartësi.

Zgjedhja inxhinjrike

Shkarkimi i ujërave të zeza do të bëhet në drejtim të kolektorit kryesor të qytetit i cili shtrihet në anën e majtë të lumit Prishtina. Pra, në të njëjtin drejtim kah janë të orientuar edhe ujërat atmosferike të lagjes.

Shkarkimin e ujërave në këtë kolektor na mundëson edhe topografia e terrenit. kështu që projektuesi ka paraparë që të ketë tri pika shkarkuese në këtë kolektor. Ndarja e tërë zonën në tetë njësi është bërë që diametrat e gypave të jenë më të vegjël.

Projektuesi ka paraparë që edhe në zonat e gjelbëruara të ketë rrjet të kanalizimit fekale pasi që në ato zona do të ketë edhe objekte përcjellëse të ndryshme për nevojat e të punësuarëve dhe objekte tjera të ngjashme.

Në bazë të llogarive hidraulike ka rrezultuar që gypi kryesor i zonën së dytë në të cilën shkarkohen ujërat e pjesës më të madhe të kësaj zone dhe i zonën së parë do të jetë me diametër DN400mm, kurse gypi i zonën së tretë është me diametër DN250mm.

- Traseja e rrjetit të kanalizimit fekal

Projektuesi ka shfrytëzuar rrjetin e rrugëve të lagjes për trasimin e rrjetit në fjalë.

Kolektori kryesor do të kaloj mesit të rrugës, kurse në vendet ku është banim i dendur do të shkoj në të dy anët e saj. Si variant optimale, në vendet ku banimi është i dendur në njërin anë ndërsa në anën tjetër kemi shfrytëzues të rrallë, duhet të shfrytëzohet ana e rrugës afër banimit si trase e kanalit.

- Ndarja e sistemit të kanalizimit fekal

I gjithë rrjeti i kanalizimit atmosferik është me gjatësi L= 13,505 m.

-	Ø 400mm	L=1,275m
-	Ø 315mm	L=1,240m
-	Ø 250mm	L=5,425m
-	Ø 250mm	L=5,565m

Dimensionimi i gypave është bërë na bazë të numrit të banorëve, nevojës ditore për banorë, koeficientin jonjëtrajshmërisë ditore dhe orare dhe rënjes së terrenit. Diametrat e këtyre gypave janë nga D-200mm deri në D-400mm.

Niveleta e gypave duhet të përshtatet rënjes së terrenit.

Materiali i gypave është nga HDPE/8 të brinjëzuar.

Vërejtje: Në raste të caktuara, në bazë të llogarive hidraulike diametri i gypit është më i vogël se D-200 mm, projektuesi ka përvetësuar diametrin D_{min} -200 mm që është diametri minimal i lejuar nga rregullat dhe normat teknike në fuqi.

RRJETI I UJËSJELLËSIT

Normat e harximit të ujit

Nga tabela e llojit të ndërtimit dhe shfrytëzuesve nëpër blloqe shihet se ekzistojnë disa lloje të shfrytëzuesve dhe rrjedhimisht edhe norma të ndryshme të harximit ditor.

Në bazë të normave në fuqi, në tabelën e mëposhtme janë dhënë normat e harximit për shfrytëzuesit:

Shfrytëzuesi	Norma	K1	K2
Banorët	200 l/d/b	1.50	1.7
Afarizëm	5 l/m ² /d		
Çerdhet, Shkollat,	8 l/nx/d		
Biblioteka, muzeu, teatri	5 l/viz/d		
Rrugët	1.50 l/m ² /d		
Gjelbërimi rekreativ	100 l/ari/d		
Parku	300 l/ari/d		
Parkingu	1.00 l/m ² /d		
Garazha, sipërf. Lira etj	0.50 l/m ² /d		

Në bazë të analizave për sasinë e nevojshme të ujit, rezulton:

- se sasia e përgjithshme për nevojat e shfrytëzuesve është $Q_{max} = 106.16$ l/s.
- Sasia e nevojshme për mirëmbajtjen e rrjetit është 10% nga sasia e tërësishme $Q_m = 10.6$ l/s.

Sasia e nevojshme për ujë është: $Q = 116.78$ l/s.

Sasia e ujit kundër zjarrit

Sipas normave në fuqi, për numrin e banorëve prej 14,332, duhet të parashihet që do të këtë dy zjarre në të njëjtën kohë, me kohëzgjatje prej 2 orëve. Sasia e nevojshme për shuarjen e këtyre dy zjarreve është $Q_z = 15$ l/s.

Sasia meritore për dimensionim

Sasia meritore për dimensionimin e rrjetit të ujësjellësit është shuma :

$$Q_{mer} = Q_{max} + Q_m + Q_z$$

$$Q_{mer} = 106.16 + 10.6 + 15,00$$

$$Q_{mer} = 131.78 \text{ l/s}$$

Gjendja ekzistuese e Infrastrukturës së ujit të pijës

Në këtë pjesë të qytetit furnizimi me ujë është përmes ujësjellësit të qytetit nga ndërmarrja publike rajonale "Prishtina " me burimet kryesore të ujit nga Liqeni i Batllavës dhe atë përmes dy rezervuarëve të vendosur në Lagjen Arbëria me vëllim $V = 15.000 \text{ m}^3$, në kuotën 650.0 m.l.m. dhe Rezervuari me stacionin e pompave në lagjen Kodra e trimave me vëllim $V = 5.000 \text{ m}^3$, në kuotën

650.00m.l.m. Për shkak të ndryshimit të disnivelit pjesa e ulët e lagjes që shtrihet përrreth hekurudhës ka furnizim me ujë nga Rezervuari i Arbërisë, ndërsa pjesa e epërme nga rruga "Ahmet Krasniqi" me furnizim nga Stacioni i pompave në Lagjen Kodra e trimave. Situata e infrastrukturën ekzistuese në lagje bazuar në informacionet e marra nga Ujësjiellësi dhe Drejtoria për shërbime publike vlerësohet se në pjesën nga rruga "Ahmet Krasniqi" deri në kufirin e hekurudhës janë kryer investime paralel me ndërtimet në këtë zonë, ndërsa pjesa tjetër e lagjes mbi rrugën "Ahmet Krasniqi" infrastruktura e ujësjiellësit është më e pakët dhe me diametra jo të mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat për zhvillimin e lagjes. Gypat kryesisht janë nga PE(HDPE), por ka edhe nga materiali tjetër si PVC ,Azbest Çimentoje dhe të zingtuar.

Planifikimi i Furnizimi me ujin e pijes

Sistemi i furnizimit me ujë të pijes është bazuar edhe në konceptin e zhvillimit të sistemit të ujësjiellësit bazuar në planet zhvillimore dhe projektet.

Furnizimi do të bëhet nga burimet ekzistuese dhe ato që janë në proces të ndërtimit. Planifikimi i furnizimit për zonën e Arbërisë bazuar edhe në modelin Hidraulik, për shkak të konfiguracionit gjeodezik të terrenit, është paraparë të ndahet në dy zona. Zonat nën kuotën 610.0m.l.m. do të furnizohen me ujë nga gypi transportues Arbëri-Park duke shfrytëzuar gypin e ri ekzistues të ndërtuar me diamet DN-400mm. Zona mbi këtë kuotë, pra nga 610.0m.l.m. deri në kuotën më të lartë 650.0 m.l.m. do furnizohet nga Rezervuari i Arbërisë përmes ndërtimit të një stacioni të ri pompave. Përveç zonës së Arbërisë do të furnizonte edhe të gjithë zonën përreth rezervuarit mbi kuotën 610.0 m.l.m. pasi që sasi të ujit që do të vijin në këtë rezervuar nga fabrika e re e përpunimit të ujit në Shkabaj, do të jenë të mjaftueshme. Kjo do të ndihmonte që furnizimi me ujë të pijes të ketë përmirësim të ndjeshëm edhe në zonat tjera si ajo e qendrës së qytetit dhe Kodra e trimave. Pasi që pjesa më e madhe e gypave ekzistues janë nga PE propozojmë që me material të njëjtë të vazhdohet edhe në pjesët tjera të lagjes.

Presionet në varësi të pozitës sillen nga 2.5 deri në 7 barë duke plotësuar të gjitha kriteret teknike për presion ekonomik.

Diametërat e gypave janë përvetësuar minimali DN-90mm dhe maksimali DN-400mm që të plotësojnë kriteret për shpenzimin maksimal orar dhe të gjitha shpenzimet plotësues siç është rrjeti i hidrantëve. Gjatësia totale e gypave të ujësjiellësit është $L=14,6000$ m.

Në dimensionim e gypave, faktorë vendimtar në përcaktimin e diametrit minimal ka qenë nevoja e transportit të ujit për shuarjen e zjarrit. $Q_z=15$ l/s. Sipas normave në fuqi kjo sasi e ujit duhet të jetë gjithmonë në dispozicion nënrrjetin e hidrantëve të instaluar në sistemin në fjalë.

Bazuar në normat në fuqi, distanca në mes të dy hidrantëve duhet të jetë 80-120 m. Projektuesi ka paraparë që hidrantët të furnizohen me ujë nga rrjeti kryesor i gypsjiellësit. Kjo zgjidhje është aplikuar pas në analize teknike-financiare, sipas se cilës ndërtimi i rrjetit të veçantë të hidrantëve rezulton me në kosto shumë të lartë ndërtimi krahasuar me koston e variantit të aprovuar.

Traseja e gypsjiellësit

Përpiluesi i dokumentacionit teknik, ka paraparë që gypsjellësi të kalon nëpër trotuare. Traseja e tillë është zgjedhur sepse mirëmbajtja e rrjetit në të ardhmen është më e lehtë.

Thellësia minimale e kanalit duhet të jetë $h_{min}=1.20$ m.

Projektuesi propozon që ndërtimi i nyjeve të bëhet mundësisht në trotuar dhe valvolat përkatëse të jenë valvola me teleskop duke eliminuar pusëtën si pengesë fizike dhe njëkohësisht zbrit koston e ndërtimit.

I gjithë rrjeti i kanalizimit atmosferik është me gjatësi $L= 14,600$ m.

-	Ø 400mm	L=1200m
-	Ø 315mm	L=135m
-	Ø 250mm	L=1230m
-	Ø 225mm	L=2900m
-	Ø 160mm	L=2400m
-	Ø 110mm	L=1480m
-	Ø 90mm	L=2700m

3.6.3 Rrjeti primar i ngrohjes qendrore

Projekti kryesor i rrjetit magjstral, të ngrohjes, për planin rregullativ të lagjes Arbëria 3 - Prishtinë, rrjeti i ngrohjes qendrore është punuar, në bazë të shënimeve dhe planeve si dhe në bazë të kërkesave specifike për objekte në veçanti (destinimit , madhësisë dhe pozitës).

Sistemi i ngrohjes është paraparë me sistem indirekt pra me nënstacione termike me kapacitete adekuate.

Rrjeti magjstral i ujit të vale të parashihet të ndërtohet me gypa të paraizoluar.

Në vendet e kyçjes së degëve të rrugëve të veçanta të parashihen pusetat e betonit me dimensione adekuate.

Në fillim të çdo kyçje të parashihen valvolat e adekuate si organe mbyllëse, ndërsa për vazhdimin e trasesë të parashihen gypat e paraizoluar me dimensione adekuate, varësisht nga konsumi i parashikuar i sasisë së nxehtësisë.

Nëpër puseta të parashihen edhe gypat me valvola për largimin e ajrit dhe zbrazjes së rrjetit magjstral.

Projekti të përpilohet në tërësi në harmoni me normat dhe standardet në fuqi, për këto lloje të instalimeve.

TUBACIONET

Dimensionimi i tubacionit të ngrohjes do të bëhet në bazë të sasisë së nevojshme për çdo objekt, me parametra të ujit primar nga Termokosi $130/70$ °C. Kalkulimet e bëra të përafërta për objektet sipas projektit të dhënë janë afërsisht 20 W/m³.

Te vendosja e tubave nën tokë, duhet patur parasysh që ti ikim ujerave nëntokësor, në mënyrë që mos i ngarkojmë punët ndërtimore dhe ngarkesat e furnizimit me ujë të ngrohtë.

Tubacionet e paraizoluara duhet të jenë të punuara nga shkuma e poliuretanit, e cila është e futur me presion, në mes të tubit të çelikut dhe shtresës mbrojtëse të plastikes në pjesën e jashtme. Këto tubacione duhet të kenë atestet e kualitetit të materialit dhe të jenë standardizuar, pra ti plotësojnë normal dhe standardet e bashkësisë evropiane.

Pozita e tubacioneve është minimum nën koten $H = -1.00$ m, çka edhe shtrirja nën rrugët nuk paraqitet ndonjë rrezik nga shembja e dheut dhe vibracionet e mundshme nga komunikacioni rrugor, sepse janë marre parasysh ngarkesat e tokës, dhe tubacioneve përcjellëse përgjatë rrugës.

I tërë instalimi duhet të kryhet kryesisht sipas dokumentacionit të projektit detal të punuar, kurse material i nevojshëm duhet të jetë i klasit të parë dhe komfort standardeve të BE-s dhe të posedoj certifikatat e kualitetit të materialeve.

Tubacionet qendrore duhet të vendosen në lokalitetet me dendësi më të madhe të ngarkese termike, në mënyrë që shpenzimet e transportit të nxehtësisë, të jenë sa më të ulëta. Për shkak të vendosjes së tubacioneve në dhe duhet të merret parasysh pozita, niveli dhe kahet e rrjetit:

Rrjeti i kanalizimit atmosferik,

Rrjeti i kanalizimit fekal;

Rrjeti elektrik

Rrjeti i ujësjellësit,

Rrjeti i telefonisë fikse

Mjetet e mundshme kabllovike etj.

ENERGJIA E NEVOJSHME PËR NGROHJE

Duke pasur parasysh se llogaritja e nevojave për ngrohje qendrore për një kompleks të banesave, për një lagje apo qytet, është një problem mjaft i ndërlikuar, për të cilin duhet të dihen shumë parametra dhe të merren parasysh shumë të dhëna, në vijim do të japim një përshkrim shumë të shkurtër dhe të përafërt për një llogari aq serioze dhe gjithëpërfshirëse.

Për caktimin e saktë të shpenzimeve të energjisë për ngrohje, duhet tu referohemi llogarive sipas DIN 4701 / 1E (08.95.),

Udhëzime për llogaritje të nxehtësisë së nevojshme dhe VDI 2067/2 (12.93),

Ngrohja në dhoma, për të cilët janë dhënë rezultatet ekzakte në varësi nga objekti. Një llogari e përafërt mund të lexohet nga diagrami në vijim:




Fig 16. : Nxehtësia e nevojshme specifike mesatare maksimale për objektet e banimit dhe për objektet afariste për m² të sipërfaqes e cila shfrytëzohet.

Nga fig. 1 mund të lexojmë se:

- Për objektet e vjetra, me madhësi 1.000 m³ , është diku 110 Ë/m²,
- Për objektet e vjetra, me madhësi 3.000 m³ , është diku 90 Ë/m²
- Për objektet e vjetra, me madhësi 5.000 m³ , është diku 80 Ë/m²
- Për objektet e vjetra, me madhësi 10.000 m³ , është diku 75 Ë/m²
- Për objektet e vjetra, me madhësi 20.000 m³ , është diku 70 Ë/m²

Sipas urdhrit administrativ për kursimin e nxehtësisë ËSVO 1982:

- Për objektet e reja, me madhësi 1.000 m³ , është diku 55 Ë/m²
- Për objektet e reja, me madhësi 3.000 m³ , është diku 45 Ë/m²
- Për objektet e reja, me madhësi 5.000 m³ , është diku 40 Ë/m²
- Për objektet e reja, me madhësi 10.000 m³ , është diku 35 Ë/m²




Fig. 17: Vlerat orientuese për nxehtësinë specifike të ngrohjes, në varësi nga vjetërsia dhe raporti A/V (sipërfaqja e jashtme përfshirëse ndaj vëllimit).

Për shtëpitë për disa familje dhe me nxehtësi specifike të nevojshme:

- Për objektet e vjetra: 80 W/m² është 0.4
- Për objektet e reja : 40 W/m² është 0.6




Fig. 18: Nxehtësia e nevojshme specifike mesatare maksimale për objekte të fabrikave për m³ të hapësirës

- Për hapësirat me vëllim 1.000 m³ është diku 1.25 Ë/m³ K
- Për hapësirat me vëllim 2.000 m³ është diku 1.00 Ë/m³ K
- Për hapësirat me vëllim 5.000 m³ është diku 0.8 Ë/m³ K
- Për hapësirat me vëllim 10.000 m³ është diku 0.6 Ë/m³ K

Për përcaktimin e saktë të kapaciteteve për ngrohje dhe të sasisë së energjisë së nevojshme, duhet të trajtohen me saktësi edhe këta faktorë:

- Sipërfaqja e saktë e objekteve ekzistuese,
- Lloji i objekteve ekzistuese,
- Madhësia e objekteve ekzistuese,
- Mundësia e ngrohjes së objekteve ekzistuese,
- Planifikimi i kritereve termike për objektet e reja që duhet ndërtuar dhe,
- Lloji i objekteve të reja të cilat ndërtohen.

Projekti kryesor i instalimeve të ngrohjes qendrore është punuar në bazë të shënimeve dhe vizatimeve të marra nga arkitektura dhe kërkesave të investitorit.

Kapaciteti i cili është kalkuluar nga llogaritjet, ku është marre 20 W/m³ duke e pas parasysh izolimin e 80% te objekteve dhe 20% te energjisë nga burime alternative, energjinë solare dhe energjinë gjeotermale kemi ardh me një kapacitet prej **Q=148.86 MË** për hapësirat e banueshme dhe afarizëm.

Tubacioni do të realizohet në atë mënyrë siç është dhënë në përshkrimin teknik dhe në dokumentacionin grafik.

Për punimin e tubacionit përdoren gypat e paraizoluar ISOPLUS apo ndonjë prodhues tjetër.

Vendet e salduara duhet të jenë të punuara mirë me trashësi të mjaftueshme të shtresës së saldimit kështu që diametri i gypit të mos ndërrojë.

PUSËTAT

Pusetat sipas funksionit parashihen për:

- a. Pajisjet për mbyllje dhe pajisjet matëse,
- b. Ajrosje dhe zbrazje,
- c. Hyrja në nënstacione shtëpiake,
- d. Kontrollë të rrjetit
- e. Ndërprerjen e ujit në raste të avarive të paraqitura

Pusetat duhet që të ekzekutohen sipas standardeve dhe normave, në atë mënyrë që gjatë intervenimeve të mundshme, ekipi e mirëmbajtës se magjistralit të ujit të ngrohje, pa pengesa ti kryen punimet e mirëmbajtjes, apo zëvendësimet e armaturave të ndryshme. Pra pusetat në parim duhet të jenë të ekzekutuara si të kalueshme për armature dhe personelin.

ZBRAZJA E RRJETIT MAGJISTRAL

Parkimi	Banim	1 VP/1 njësi banimore	
	Afarizëm	1 VP/ 40 m2 (netto)	
E 3.2	Sipërfaqja për QERDHE (m2)	3033.8	
	ISHP- Indeksi I shfrytëzimit të parcelës	30%	
	ISGJ- Indeksi I sipërfaqes së gjelbërimit	40%	
	ISHN- Indeksi I shfrytëzimit të nëntokës	60%	
	Sipërfaqja maksimale e shputës (m2)	910.14	
	Numri maksimal I kateve	max P+1	
	Vija ndërtimore	5.0 m, 7.5 m, 10.0 m	
Parkimi	Staf	1 VP/1 Punëtor	
	Prindër	1 VP/ 10 fëmijë	
	Ngastrat që përfshihen	2981-5, 2969-0, 2983-0, 2982-0, 2981-3, 2981-4, 2964-0	

ID	Tërësia	PRERIJA	
	Blloku	E 4	
	Destinimi	Banim I mesëm	
	Sipërfaqja e tërësisë hapësinore (m2)	13603.2	
E 4	ISHP- Indeksi I shfrytëzimit të parcelës	30%	
	ISGJ- Indeksi I sipërfaqes së gjelbërimit	40%	
	ISHN- Indeksi I shfrytëzimit të nëntokës	60%	
	ISPN-Indeksi I sipërfaqes së përgjithshme të ndërtuar	1.5	
	Sipërfaqja maksimale e shputës (m2)	4080.96	
	Numri maksimal I kateve	max P+4	
	Vija ndërtimore	7.5 m	
	Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës	nëse ka kthina primare	min 0.75 H
		nëse ka kthina sekondare	min 0.25 H
		në marrëveshje me fqin	min 0 H-0.25 H
	Distanca minimale në mes të dy ndërtesave	min 1 H	
Parkimi	Banim	1 VP/1 njësi banimore	
	Afarizëm	1 VP/ 40 m2 (netto)	
	Ngastrat që përfshihen	2968-1, 2967-10, 2967-9, 2967-8, 2967-7, 2967-6, 2967-14, 2967-13, 2967-12, 2967-11, 2967-4, 2966-0, 2968-5	

ID	Tërësia	PRERIJA	
	Blloku	E 5	
	Destinimi	Banim I mesëm	
E 5	Sipërfaqja e tërësisë hapësinore (m2)	16805.8	
	ISHP- Indeksi I shfrytëzimit të parcelës	30%	
	ISGJ- Indeksi I sipërfaqes së gjelbërimit	40%	
	ISHN- Indeksi I shfrytëzimit të nëntokës	60%	
	ISPN-Indeksi I sipërfaqes së përgjithshme të ndërtuar	1.5	
	Sipërfaqja maksimale e shputës (m2)	5041.74	
	Numri maksimal I kateve	max P+4	
	Vija ndërtimore	7.5 m	
	Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës	nëse ka kthina primare	min 0.75 H
		nëse ka kthina sekondare	min 0.25 H
		në marrëveshje me fqin	min 0 H-0.25 H
		Distanca minimale në mes të dy ndërtesave	min 1 H
	Parkimi	Banim	1 VP/1 njësi banimore
		Afarizëm	1 VP/ 40 m2 (netto)
	Ngastrat që përfshihen	2965-3, 2965-1, 2965-4, 2957-0, 2965-1?, 2965-5, 2965-7, 2965-2	

ID	Tërësia	PRERIJA	
	Blloku	E 6	
	Destinimi	Banim I mesëm	
E 5	Sipërfaqja e tërësisë hapësinore (m2)	17637.9	
	ISHP- Indeksi I shfrytëzimit të parcelës	30%	
	ISGJ- Indeksi I sipërfaqes së gjelbërimit	40%	
	ISHN- Indeksi I shfrytëzimit të nëntokës	60%	
	ISPN-Indeksi I sipërfaqes së përgjithshme të ndërtuar	1.5	
	Sipërfaqja maksimale e shputës (m2)	5291.37	
	Numri maksimal I kateve	max P+4	
	Vija ndërtimore	7.5 m	
	Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës	nëse ka kthina primare	min 0.75 H
		nëse ka kthina sekondare	min 0.25 H
		në marrëveshje me fqin	min 0 H-0.25 H
		Distanca minimale në mes të dy ndërtesave	min 1 H
	Parkimi	Banim	1 VP/1 njësi banimore
		Afarizëm	1 VP/ 40 m2 (netto)
	Ngastrat që përfshihen	2956-2, 2956-3, 2955-6, 2955-4, 2955-4, 2955-2, 2955-3, 2955-1, 2956-1, 2955-5, 2956-4	

ID	Tërësia		PRERIJA
	Blloku		E 7
	Destinimi		B. I mesëm dhe I lartë
	Sipërfaqja e tërësisë hapësinore (m2)		17006.5
E 7.1	Sipërfaqja për banim të lartë max P+5		8032.4
	ISHP- Indeksi I shfrytëzimit të parcelës		30%
	ISGJ- Indeksi I sipërfaqes së gjelbërimit		40%
	ISHN- Indeksi I shfrytëzimit të nëntokës		60%
	ISPN-Indeksi I sipërfaqes së përgjithshme të ndërtuar		1.8
	Sipërfaqja maksimale e shputës (m2)		2409.72
	Numri maksimal I kateve		max P+5
	Vija ndërtimore		7.5 m, 10.0 m
E 7.2	Sipërfaqja për banim të lartë max P+6		8974.1
	ISHP- Indeksi I shfrytëzimit të parcelës		30%
	ISGJ- Indeksi I sipërfaqes së gjelbërimit		40%
	ISHN- Indeksi I shfrytëzimit të nëntokës		60%
	ISPN-Indeksi I sipërfaqes së përgjithshme të ndërtuar		2.1
	Sipërfaqja maksimale e shputës (m2)		2692.23
	Numri maksimal I kateve		max P+6
	Vija ndërtimore		7.5 m, 10.0 m
	Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës	nëse ka kthina primare	min 0.75 H
		nëse ka kthina sekondare	min 0.25 H
		në marrëveshje me fqjün	min 0 H-0.25 H
	Distanca minimale në mes të dy ndërtesave		min 1 H
	Parkimi	Banim	1 VP/1 njësi banimore
		Afarizëm	1 VP/ 40 m2 (netto)
	Ngastrat që përfshihen	2959-3, 2959-6, 2959-4, 2958-0, 2962-16, 2962-15, 2962-14, 2962-13, 2962-12, 2962-11, 2962-10, 2962-9, 2961-0, 2960-0	

4.0 EVIDENTIMI I NDRYSHIMEVE NË MES TË PLANEVE

4.1 EVIDENTIMI I NDRYSHIMEVE NË MES TË PLANIT ZHVILLIMOR URBAN DHE PLANIT RREGULLUES URBAN TË REVIDUAR


Në mes të Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues të reviduar nuk ka ndonjë ndryshim që do të ndikonte cenimin e planit. Ndryshimet e vetme janë në bllokun C4, B4, D3 që nënkuptojnë ndryshim destinimi për të mirën publike. Kështu blloku D3, i cili në PZHU vjen si një destinim i padefinuar (sepse përshkrimi është gjelbrim), është planifikuar për përmbajtje arsimore dhe sportive. Kjo për arsye të pronësisë së tokës.

BLOKU D 3



Në bllokun C4, në pjesë e dedikuar për shërbime publike është shëndërruar në banim të mesëm, në mënyrë që hapësira e destinuar për banim kolektiv me PRRU-në e vjetër të mos e cenojë këtë tërësi.⁹

PJESË E BLOKUT B4




Blloku B4, respektivisht këndi perëndimor i saj, ndonëse me PZHU i destinuar si banim miks është planifikuar për qendrën e sigurisë. Arsyeja e ndërrimit të destinimit lidhet me situatën në terren, me ndërtesat ekzistuese dhe rrugën kryesore ekzistuese të cilin ky plan e ka marrë parasysh

⁹ Për më shumë informata shih.kapitullin "Format e implementimit"


ndërsa në PZHU ai është paraparë (zhvendosur) më poshtë. Me PRRU-në e vjetër kjo pjesë është udhëkryq rrugor , respektivisht një ishull me gjelbrim.

BLOKU A 3



Për shkak të kërkesës së banorëve për banim të ultë, pjesa e veriore e bllokut A2 është destinuar për banim të ultë. Ndërsa qerdhja është paraparë sipas PZHU-së.

BLOKU A 2




4.2 EVIDENTIMI I NDRYSHIMEVE NË MES TË PLANIT RREGULLUES URBAN EKZISTUES DHE PLANIT RREGULLUES URBAN TË REVIDUAR

Parcela 6144- pjesë e blloqeve A2, A1, B9

Gjendja ekzistuese- një nga problemet kryesore të kësaj parcele është shfrytëzimi i parcelës nga shtëpitë ekzistuese në pjesën veriore. Gjithashtu rruga e cila e ndanë parcelën në disa pjesë të cilat janë të papërshtatshme për shfrytëzim.

Edhe me planin e vjetër rruga kalon nëpërmes parcelës duke mos e funksionalizuar një pjesë të konsiderueshme të saj. Sipas këtij plani 36% e sipërfaqes është e shfrytëzuar për rrugë dhe vetëm 10 % për banim.

Me planin e reviduar rruga është zhvendosur deri në kufi të ngatrave të banimit ekzistues të ultë duke e funksionalizuar më shumë parcelën. Me këtë rast parcela është destinuar për : banim të ultë në pjesën sipërme, banim të lartë deri në P+5 si dhe shkollë.



Blloku C4

Për të mos e cenuar situatën ekzistuese të bllokut C4 ,në të cilën është ndërtuar ndërtesa e Komunës , si dhe duke u bazuar në marrëveshjen në mes të C4 dhe C3 për zhvendosjen e rrugës në aksin e parcelave (mes C3 dhe C4) është ripozicionuar dhe rritur sipërfaqja për pjesën e dedikuar për banim.

Sipas planit të vjetër në hapësirën e ndërtesës së Komunës janë të dedikuara edhe 154.86 m²për banim të lartë. Meqenëse kjo është sipërfaqe relativisht e vogël për zhvillim në tërë bllokun , atëherë plani I reviduar ka propozuar rritjen e sipërfaqes. Në këtë sipërfaqe pjesëmarrës është edhe komuna. Sipas propozimit, parkingu ekzistues I komunës duhet të ridizajnohet ose të shiqohet mundësia e ndërtimit nën tokë (meqë një pjesë e konsiderueshme është terren I pjerrtë). Një nga mundësitë është edhe ndërtim në marrëveshje në mes të komunës dhe investitorit privat.



5.0 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME TË RREGULLIMIT

5.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME

Intervenimet e lejuara në ndërtesat me destinim të kundërt nga ai i planifikuar

Me plan lejohet intervenimi në ndërtesate banimit, destinimi i të cilave është në kundërshtim me atë të planifikuar, nëse ka për qëllim përmirësimin e kushteve të banimit.

Intervenim me qëllim të përmirësimit të kushteve të banimit konsiderohet:

- ndërrimi dhe sanimi i kulmit, pa ndryshim të dukjes së jashtme
- ndërrimi ose sanimi i pjesëve konstruktive të ndërtesës, pa ndryshim të pamjes së jashtme të ndërtesës dhe pa ndryshim të formës së jashtme të tij.

Ndërtesa ekzistuese konsiderohen ato që janë të ndërtuara deri në vitin 2014 dhe ndërtesat të cilat janë ndërtuar mbi bazë legale të lejes së ndërtimit.

Kushtet e përgjithshme për vendosje të ndërtesave të përkohshme

- do të përcaktohen sipas rregullores për procedurën e ndërtimit me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizik dhe juridik.

Komunikimi vertikal

- ndërtesat me më shumë se 5 etazhe (ose lartësi max.25m) duhet të kenë së paku njëashensor

Kushtet për përcaktimin e kotës së përdhesës

Kuota e përdhesës së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e niveletës së rrugës publike gjegjësisht në krahasim me kuotën zero:

- kuota e përdhesës së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se sa kuota e niveletës së rrugës publike
- kuota e përdhesës mund të jetë më së shumti 1.2 m mbi kuotën zero
- për ndërtesa që në përdhesë kanë tregti apo shërbime, kuota e përdhesës mund të jetë më madhe se kuota e trotuarit për (max) 0.3 m.

Në raste kur nuk mund të zbatohen këto rregulla, kur terreni është i pjerrtë atëherë:

- përdhesa përcaktohet në bazë të rrugës më të afërt për qasje si dhe në bazë të vijës ndërtimore në vertikale (shih.shembujt).
- Vija ndërtimore në vertikale është e përcaktuar në bazë të etazhitetit maksimal të përcaktuar për secilin bllok veç e veç.
- Çdo gabarit I cili del deri në 1.2 m mbi kuotën zero llogaritet suterren.
- Koeficienti ndërtimor për suterren llogaritet 50% e sipërfaqes së ndërtesës dmth suterreni do të trajtohet nëse mbi 50% e vëllimit të etazhës hyn nën tokë
- Suterren tek terrenet e pjerrëta konsiderohet nëse vëllimi I etazhiteteti hyn mbi 50% mbi

tokë.




Fig.21 Vija ndërtimore në vertikale

Kushtet për lëvizje pa pengesa të personave me aftësi të kufizuara

- ndryshimet më të mëdha se 13 mm të nivelit të sipërfaqes ku qarkullohet, duhet të punohen si rampa
- rampat nuk lejohet të kenë pjerrtësi më të madhe se 5%, për gjatësi deri 600 cm
- për gjatësi më të madhe duhet të punohen pushimore min 200cm
- nëse rampa është e mbuluar lejohet pjerrtësi deri 8%
- dyshemeja e rampave duhet të jetë e fortë, rezistente ndaj rrëshqitjes
- duhet të sigurohet 1 parking për persona me aftësi të kufizuar për çdo 30 vendparkime
- parkingu për persona me aftësi të kufizuar duhet të jetë min.350 cm i gjërë, ose të punohet në kombinim me hapësirën për manipulim 230+120 mm
- madhësia min. e ashensorit duhet të jetë 110 x 140 cm, por preferohet të mos dimensionohet për më pak se 8 persona

Për kushte të tjera të konsultohet dokumenti "Përshtatshmëria e ndërtesave për persona me aftësi të kufizuar" nga HANDIKOS, FDI, USAID, EWMI.

Konzollat

_Ballkonet mund të kalojnë vijën ndërtimore (kur nuk përputhet me vijën rregulluese) më së shumti deri 1.2m. Konzollat më të mëdha se 1.2 m nuk mund të kalojnë vijën ndërtimore, ato duhet të vendosen brenda saj.

Shkallët e jashtme

Shkallët e jashtme të hapura të cilat kanë lartësinë mbi 1.2m, nuk lejohet të vendosen mes vijës rregulluese dhe ndërtimore.

Rampat– duhet të planifikohen në atë mënyrë që të mos pengojnë lëvizjen e këmbësorëve. Rampat nuk lejohen të vendosen mes vijës rregulluese dhe ndërtimore.

Gardhi

Parcelat ndërtimore të ndërtesave publike (përveç çerdheve/kopshteve dhe shkollave) dhe të banimit kolektiv nuk duhet të rrethohen.


Ku lejohet përdorimi i gardhit për ndërtesë:

- lejohet rrethim me gardh deri në lartësi 1.2 m (nga kuota e trotuarit)
- gardhi duhet të vendoset në vijën rregulluese, në formë që shtyllat e gardhit të gjenden brenda parcelës ndërtimore që rrethohet
- dyert duhet të hapen brenda vijës rregulluese
- gardhet të cilat janë të ndërtuara dhe të cilat dalin nga rregullat e përcaktuara me këtë plan, duhet të ndryshohen me qëllim të ruajtjes së interesit të përgjithshëm (siguri, dukje estetike, higjienë)

Dukja e jashtme e ndërtesave dhe materiali

Me qëllim të sigurimit të harmonisë së tërësisë urbane dhe krijimit të relacionit të shëndoshë mes ndërtesave dhe vendit duhet respektuar rregullat si më poshtë.

- inkurajohet përdorimi i materialeve natyrore (tullë, dru, gurë e të ngjashme)
- kulmi mund të jetë i pjerrët apo i rrafshët
- këndi maksimal i kulmit të pjerrët duhet të jetë 45°
- nuk lejohet aplikimi i kulmit mansardë
- nuk lejohet përdorimi i ngjyrave bazë, të cilat mund të jenë intensive (të papërziera me ngjyra tjera apo shkallë të hirtë) ose të zbutura-akuarele (ngjyra bazë e zbutur me ngjyrën e bardhë) sikur në skicën 1)
- inkurajohet përdorimi i ngjyrave pastelev, sipas paletës në skicën 2, ose të ngjashme
- duhet të minimizohet përdorimi i ngjyrave, sidomos atyre që tërheqin vëmendjen
- nuk lejohet përdorimi i dritareve-pasqyrë dhe me ngjyrë
- inkurajohet arkitekturë e thjeshtë, e pastër, pa shumë detaje.
- materialet duhet të reflektojnë destinimin e ndërtesës
- sugjerohet shmangja nga fasadat e tej-dizajnuara
- të minimizohet përdorimi i materialeve të rrezikshme,
- udhëzohet përdorimi i materialit të prodhuar në vend pas demolimit (ri-përdorimi)



Kërkesat për peizazh

- të sigurohet qasje për të gjithë, përmes sigurimit të shkallëve, rampave (me dorëza) ku ka ndryshime të nivelit
- të shfrytëzohen materiale të forta, jo të rrëshqitshme
- të realizohet drenazhi për të siguruar rrjedhën e ujit atmosferik në sipërfaqen e tokës.
- ndriçimi të potencojë materialet e peizazhit (të forta dhe të buta) dhe minimizojë hijet e thella
- lokimi i vendeve për ulje të ofrojë zgjedhje për diell, hije si dhe të mundësohet strehim nga të reshurat
- sugjerohen materialet e forta dhe jo të rrëshqitshme për dyshemesi: guri i përpunuar, pllaka argjilore, betoni e të ngjashme
- Të përdoren materialet me teksturë që ndihmojnë orientimin, orientojnë lëvizjen (të ndihmojnë njerëzit me pengesa në të pamur)
- të evitohen pengesat në vijat e lëvizjes

Kushtet për vendosje të mobiliarit urban

Mobiliari duhet që:

- të bëhet i thjeshtë
- të përcjell dizajnin në nivel të qytetit nëse është vendosur
- ndriçimi të përdoret si mjet për të pamundësuar krimin
- gjatë pajisjes së hapësirave publike, dizajni dhe zgjedhja e mobiliarit urban të paraqesë vepra të artit publik

Nuk preferohet përdorimi i materialeve të cilat ndikojnë në perceptimin e vështirët hapësirës (psh. stacionii autobusëve krejt në xham), për shkak të vështirësive në komunikim që u shkakton, njerëzve me vështirësi në të pamur.

Kiosqet:

- nuk mund të jenë të muratuar nga tullat, betoni ose elemente tjera të ngjashme ndërtimore
- ndërtesat duhet të jenë montazhe (për të plotësuar kriterin e largimit për 24 orë)
- vendosen në zonë e trotuarit me kushtin themelor për të mos penguar lëvizjen e lirë të këmbësorëve

Panotë e reklamave:

- sipas rregullës vendosen në zonë e shiritit të gjelbërt të rrugëve me qëllim që të mos pengojnë shikueshmërinë në trafik
- duhet të vendosen në shtylla mbi lartësinë min.2.0 m.

Kushtet e veçanta për rregullim në rrugën "Ahmet Krasniqi"

Përmes kushteve të ndërtimit të sigurohet që:

- ndërtimet në rrugën kryesore "Ahmet Krasniqi" të jenë në harmoni njëra me pjesën tjetër të rrugës
- Sugjerohet që ndërtesat ta kenë kuotën e njëjtë të përdhësës,
- të ketë lidhshmëri mes funksioneve në përdhësë të ndërtesave,
- të favorizohen shërbimet hoteliere (restorante, kafene, ëmbëltore e të ngjashme)dhe tregtare (dyçane rrobash, aksesoresh, teknikës etj)
- të sigurohen vende për ulje
- të sigurohen hije në vijat kryesore të lëvizjes dhe në vendet për ulje,me anë të gjelbërimit të lartë
- gjelbërimi përgjatë rrugës të shërbejë edhe si tampon izoluesi zhurmës dhe ndotjes

Kushtet e veçanta për rregullimin e shesheve në kuadër të blloqeve të banimit

- të respektohen vijat e lëvizjes duke mos vënë pengesa për lëvizje
- të planifikohen vende për ulje nën hije të drunjve
- të planifikohet gjelbërimi i lartë sipas dispozitave nga kapitulli i gjelbërimit, e posaçërisht t'i kushtohet rëndësi mbjelljes së drunjve izolues dhe dekorativ.
- të planifikohen sipërfaqe të ujit- fontana, kroje etj.

Kushtet për ndërrim destinimi

Kërkesat për ndërrim destinimi mund të vijnë në konsiderim vetëm në rastet e përmbajtjeve që kanë të bëjnë për interesat e përgjithshme të qytetit si dhe në rastet e kërkesave me destinim të veçantë psh ambasada apo ato fetare. Këto të fundit, përpos plotësimit të kushteve të përcaktuara me rregulloret e komunës duhet të plotësojnë kriteret lidhur me zhurmën.

Kushtet për objektet ekzistuese dhe ato në ndërtim e sipër

Tek ndërtesat e realizuara sipas planit të vjetër (Planit Rregullues Urban *Ref..L-01-81/04*), vija ndërtimore është vendosur duke u bazuar në vijën ekzistuese të ndërtesave. Në rastet kur një hapësirë me ndërtesa të realizuara do të transformohet plotësisht atëherë ajo duhet t'i nënshtrohet kushteve të parapara me planin e reviduar.

Ndërsa të gjitha objektet të cilat janë në ndërtim e sipër të konstatuara sipas inçizimit gjeodezik (nëntor 2014) do të trajtohen me kriteret e Planit Rregullues Urban (*Ref..L-01-81/04*).

Zgjidhjet urbane dhe lejet urbanistike të miratuara me planin e vjetër (PRRU Ref..L-01-81/04) nuk do të mirren parasysh por do të trajtohen me planin rregullues të reviduar.

5.2 RIPARCELIZIMI

Procesi i zhvillimit të suksesshëm të zonës është ngushtë i ndërlidhur me komponentin e rregullimit të pronës me anë të procesit të riparcelimit.

Planifikimi i tokës duhet të zhvillohet në atë mënyrë që të ruhet sa më shumë prona d.m.th. të dëmtojë sa më pak shfrytëzuesit / pronarët e parcelës.

Me qëllim të rregullimit të zonës duhet medeomos të parashihet riparcelizimi i atyre parcelave që nuk mund të zhvillohen pa pasur qasje në rrugë dhe që nuk plotësojnë kushtet për planifikimin e parcelës për destinim të caktuar.

Planifikimi i tokës duhet të shfrytëzojë sa më shumë potencialet e parcelave si dhe të rrisë vlerën e tyre. Parcelat që nuk i plotësojnë kushtet për vendosjen e veprimtarive të caktuara duhet të futen në proces të riparcelimit apo bashkimit në tërësi më të mëdha. Varësisht nga madhësia e parcelave si dhe forma e tyre, mund të planifikohen funksionet e caktuara me kapacitete përkatëse.

Nga hulumtimi i formës dhe madhësisë së parcelave në lokacion shihet se shumica e parcelave janë të mëdha dhe se një numër i madh i tyre janë të çrregullta ndërsa një sasi e konsiderueshme e tyre janë të përshtatshme për zhvillim.

Edhe pse plani ka paraparë riparcelimin megjithatë ai riparcelim mund të pësojë ndryshime varësisht prej kërkesave të pronarëve dhe interesit të komunës. Por gjithnjë duke i respektuar rregullat urbane të përcaktuara me plan.

Në rastet kur blloku është realizuar dhe ka mbetur një parcelë e pandërtuar atëherë komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e planifikimit në atë sipërfaqe duke mos i cënuar kushtet e përcaktuara me plan.

Parcelat e vogla të cilat janë të papërshtatshme për zhvillim si rezultat i mos plotësimit të kushteve të planifikimit të parcelës medeomos kërkon komasacionin e tokës, gjegjësisht duhet të ketë mundësinë e bashkimit të disa pronave në një pronë të përbashkët.

Parcelat e mbetura të papërfshira në zgjidhjet urbane mund të inkorporohen në rast se plotësohen kriteret e planit ose në të kundërtën mund të bëhet transferi i koeficientit në blloqe tjera.

Në rastet kur ndërtimi është i pamundur për shkak të objekteve ekzistuese atëherë sipërfaqja e planifikuar në bazë të kushteve të asaj copëze të parcelës mund të transferohet në parcelën gjegjëse. Mirëpo parcela për të cilën është bërë transferimi më tutje nuk gëzon më të drejtën e rikalkulimit.

Riparcelimi i parcelave në zonën e përfshirë me plan rregullues duhet t'iu përshtatet tregut dhe kërkesës së investitorëve dhe pronarëve, andaj duhet të jepen disa mundësi.

Duke u bazuar në gjendjen aktuale ekzistojnë tri mundësi të riparcelizimit:

a. riparcelizimi me riformësimin e parcelave ekzistuese

b. riparcelizimi i pjesërishëm i një blloku urban varësisht prej kërkesës së pronarëve

c. riparcelizim i tërësishëm i një blloku urban

a. riparcelizimi me anë të riorganizimit/riformësimin të parcelave mund të bëhet nëse të gjitha parcelat ekzistuese që i takojnë një blloku urban rivendosen në atë mënyrë që secila parcelë duhet të ketë qasje në rrugë publike. Me riorganizimin e tillë iu mundësohet secilës parcelë të radhitet në formë të rregulltë drejtkëndëshe, me mundësinë e vendosjes së ndërtesave në mënyrë perimetrike ndaj bllokut. Kjo formë e riparcelizimit shfrytëzohet për riorganizimin e parcelave për banim individual.

Kjo formë e riparcelizimit do të ndihmojë në rritjen e vlerës së zonës dhe do t'iu mundësojë pronarëve dhe/ose investitorëve zhvillim më të lehtë të veprimtarive të ndryshme poashtu edhe në planifikimin e ndërtesave në harmoni me njëra tjetrën. Me qëllim që kjo formë e riorganizimit të ketë sukses duhet që të gjithë pronarët e parcelave që ndodhen brenda një blloku urban të bashkëpunojnë në mes veti dhe me ndihmën e autoriteteve lokale të bëhet riformësimi i pronave.

b. riparcelizimi i pjesërishëm është një mundësi tjetër dhe në fakt ka të bëjë me bashkimin e dy apo më shumë parcelave ekzistuese të cilat janë të papërshtatshme për zhvillimin e veprimtarive banimore multi-familjare. Bashkimi i parcelave mund të bëhet varësisht prej kërkesës së pronarëve / investitorëve. Kjo formë e riparcelimit të pjesërishëm krahasuar me riparcelimin me anë të riformësimin të të gjitha parcelave, nuk involvon të gjithë pronarët e parcelave brenda një blloku por vetëm ata pronar të cilët janë të interesuar dhe kanë mundësi të investojnë në parcelat e tyre pasi që nuk i plotësojnë kushtet për planifikimin e parcelës për veprimtari të caktuar.

c. riparcelizimi i tërësishëm do të thotë komasacioni i të gjitha pronave që ndodhen brenda një blloku urban. Kjo formë e riparcelizimit duhet të mundësohet atëherë kur ekziston kërkesa për një zhvillim / investim në një parcelë të vetme të madhe brenda një blloku perimetrik.

Bashkimi i të gjitha parcelave në një bllokë urban krijon mundësi të shumëfishta të zhvillimit të çfarëdo veprimtarie. Moskufizimi në organizim ndihmon në organizimin ideal të ndërtesave, qarkullim efikas të trafikut brenda bllokut, hapësirë të gjelbër më të madhe dhe vet blloku mund të funksionoj si një celulë me të gjitha përmbajtjet e nevojshme.

Duke marr parasysh gjendjen aktuale të parcelave dhe të ndërtimeve kjo formë e riparcelizimit të një blloku është më vështirë të implementohet.

Bashkëpronësia

Përgjegjësitë e komunës ndaj ndërtesave në bashkëpronësi duhet të jenë konform Ligjit për ndërtesat në bashkëpronësi Nr.04/L-134, Neni 36.

Te parcelat kadastrale të bashkuara për ndërtim të ndërtesës shumëbanesore, sipërfaqja jashtë ndërtesës do të trajtohet pas përfundimit të ndërtesës si hapësirë publike duke u bazuar në Nr.04/L-134, Neni 36, Pika 1, kurse pjesa e parcelës nën ndërtesë do të trajtohet si bashkëpronësi e tërë ndërtesës.

Për parcelat që janë në bashkëpronësi por kanë për qëllim realizimin e planit, lejohet ndarja e parcelave që do të hyjnë në ndërtim sipas sipërfaqës në certifikantën poseduese- pjesa e bashkëpronësisë. Kësaj ndarje do t'i paraprijë zgjidhja urbane e miratuar nga kjo drejtori.

5.3 FORMAT E IMPLEMENTIMIT TË BLOQEVE

FORMAT E IMPLEMENTIMIT TË BLOQEVE NË TË CILAT PËRMBAJTET PUBLIKE JANË PARAPARË NE TOKË PRIVATE.

Mungesa e pronës publike dhe kërkesat që rrjedhin gjatë procesit të planifikimit për planifikimin e përmbajteve përcjellëse të banimit si psh qerdhe, shkolla , parqe, qendra të komunitet etj, paraqet njërin ndaj problemeve më mëdha të planit. Në bazë të ligjit eksitojnë disa mënyra për zgjidhjen e këtij problemi:

- përmes shpronësimit apo
- përmes ndërrimit të tokës

Vërejtje: Ekziston edhe një mënyrë tjetër e implementimit e cila lidhet me ngritjen e koeficientëve por gjithëmonë duke mos i çenuar kriteret maksimale të dhëna nga Plani Zhvillimor Urban. Përmes përvetësimit të kriterëve më të ulta të PZHU-së, plani ofron më shumë mundësi implementimi për komunën lidhur me realizmin e të mirave publike.

DISA NGA RASTET KU MUND TË APLIKOHET METODA ME NGRITJE TË KOEFICIENËVE

BLLOKU C2.4

- Sipas PZHU-së katësia e paraparë është P+7, ndërsa koeficienti 0.3-0.4.
- Sipas planit të vjetër, sipërfaqe e zhvilluar mbi tokë I ka takuar 19364 m².
- Sipas planit të reviduar, sipërfaqe e zhvilluar në tokë I takon 19602 m².

Mënyra më e detajuar e llogaritjes është dhënë në tabelat e mëposhtme:

LLOGARITJET SIPAS PLANIT TE VJETER							
a	b	c	d	e	f	g	h
SIP. E PARCELES /m ² C2/4 C2/2	ISHP	ISPN	ISHN	ISGJ	ETAZHITETI (P+5)	SIP. E SHPUTES SIP E AFARIZMIT	SIP. E ZHVILLUAR MBI TOKE
						a x b	a x c
7645	0.6	2.2	0.6	0.4	6	4587	16819
1212	0.6	2.1	0.6	0.4	5	727.2	2545.2
SIPAS PLANIT TE VJETER							19364.2

LLOGARITJET SIPAS PLANIT TE RI							
PARCELA E PARAPARE PER GJELBRIM							
SIP. E PARCELES /m ²	ISHP	ISPN	ISHN	ISGJ	ETAZHITETI (P+6)	SIP. E SHPUTES SIP E AFARIZMIT	SIP. E ZHVILLUAR
						a x b	a x c
3500	0.3	1.8	0.6	0.4	7	1050	6300
PARCELA E PARAPARE PER BANIM TE LARTE ME KOEFICIENT 3.0							
SIP. E PARCELES /m ²	ISHP	ISPN	ISHN	ISGJ	ETAZHITETI (P+8)	SIP. E SHPUTES SIP E AFARIZMIT	SIP. E ZHVILLUAR
						a x b	a x c
6534	0.4	3	0.6	0.4	9	2613.6	19602
ISHP- INDEKSI I SHPUTËS, ISPN- INDEKSI I SIPËRFAQE SË PËRGJITHSHME, ISHN- INDEKSI I SHFRYTËZIMIT TË NËNTOKËS, ISGJ- INDEKSI I SIPËRFAQES SË GJELBËR							

Nga këto llogari shihet se tejkalimi bëhet vetëm për 1 etazhë nga kriteri I dhënë me PZHU. Me këtë rast fitohet parku prej 3500 m² si dhe qerdhe/kopshti e paraparë në përdhësën e ndërtesës me sipërfaqe prej 600m².

BLLOKU C2.6

- Sipas PZHU-së katësia e paraparë është P+7, ndërsa koeficienti 0.3-0.4.
- Sipas planit të vjetër- katësia max 7, sipërfaqe e zhvilluar mbi tokë I ka takuar 11596 m².
- Sipas planit të reviduar, sipërfaqe e zhvilluar në tokë I takon 12507 m².

Mënyra më e detajuar e llogaritjes është dhënë në tabelat e mëposhtme:

LLOGARITJET SIPAS PLANIT TE VJETER							
a	b	c	d	e	f	g	h
SIP. E PARCELES /m ² C2/6	ISHP	ISPN	ISHN	ISGJ	ETAZHITETI (P+5)	SIP. E SHPUTES SIP E AFARIZMIT	SIP. E ZHVILLUAR MBI TOKE
						a x b	a x c
2982.47	0.7	2.4	0.6	0.4	7	2087.729	7157.928
1849.25	0.7	2.4	0.6	0.4	7	1294.475	4438.2
					SIPAS PLANIT TE VJETER		11596.13
LLOGARITJET SIPAS PLANIT TE RI							
PARCELA E PARAPARE PER BANIM TE LARTE ME KOEFICIENT 2.4							
SIP. E PARCELES /m ²	ISHP	ISPN	ISHN	ISGJ	ETAZHITETI (P+8)	SIP. E SHPUTES SIP E AFARIZMIT	SIP. E ZHVILLUAR
						a x b	a x c
5211.33	0.3	2.4	0.6	0.4	8	1563.399	12507.192
					SIPAS PLANIT TE RI		12507.192
ISHP-INDEKSI I SHPUTËS, ISPN-INDEKSI I SIPËRFAQE SË PËRGJITHSHME, ISHN- INDEKSI I SHFRYTËZIMIT TË NËNTOKËS, ISGJ- INDEKSI I SIPËRFAQES SË GJELBËR							

Nuk ka tejkalime sa I përket katësisë së paraparë me PZHU. Përpos përfitimit të sipërfaqes më të madhe të ndërtimit fitohet edhe parku në sipërfaqe prej 1780 m².

PARCELA 6177 (pjesë e bllokut A1, A2,B9)




Fig. 22. Parcela 6177 pjesë e bllokut A2, B9 a) gjendja ekzistuese; b) sipas PRRU-së së vjetër; c) sipas planit të reviduar.

Llogaritjet bazuar në sipërfaqet e destinuar sipas Planit të vjetër dhe planit të reviduar:

SIPAS PLANIT TË REVIDUAR			SIPAS PLANIT TË VJETËR		
	DESTINIMI	m2		DESTINIMI	m2
1	BANIM I ULTË	1592.6	1	BANIM I ULTË	1593.78
2	BANIM I MESËM	5627.02	2	BANIM I MESËM	154.86
3	SHKOLLË	5713.63	3	BANIM I LARTË	1149.95
4	RRUGË	3738.75	4	SHKOLLË	2919.83
	TOTAL NGA STRA	16672	5	GJELBRIM	4926.26
			6	RRUGË	5927.32
				TOTAL NGA STRA	16672

Tab.x Destinimi i spërfaqeve dhe madhësia e tyre bazuar në planin e vjetër dhe planin e reviduar (parcela 6177)

Nga kjo shihen përparësitë respektivisht përfitimet sidomos në destinimin e banimi të mesëm. Sipas llogarive detale rrjedh se nga sipërfaqja e gjithmbarshme e destinuar për ndërtim (2056 m²) sipas planit të vjetër, sipërfaqja rritet për gati 6400 m² dmth total në 8440 m². Më poshtë janë të prezentuara llogaritjet detale:

LLOGARITJET SIPAS PLANIT TE VJETER							
a	b	c	d	e	f	g	h
SIP. E PARCELES /m2 B1 , B7	ISHP	ISPN	ISHN	ISGJ	ETAZHITETI (P+5)	SIP. E SHPUTES SIP E AFARIZMIT	SIP. E ZHVILLUAR MBI TOKE
						a x b	a x c
154.86	0.5	1.4	0.6	0.4	4	77.43	216.804
1149.95	0.5	1.6	0.6	0.4	5	574.975	1839.92
					SIPAS PLANIT TE VJETER		2056.72
LLOGARITJET SIPAS PLANIT TE RI							
PARCELA E PARAPARE PER BANIM TE MESHËM ME KOEFICIENT 1.5							
SIP. E PARCELES /m2	ISHP	ISPN	ISHN	ISGJ	ETAZHITETI (P+8)	SIP. E SHPUTES SIP E AFARIZMIT	SIP. E ZHVILLUAR
						a x b	a x c
5627.02	0.3	1.5	0.6	0.4	5	1688.106	8440.53
					SIPAS PLANIT TE RI		8440.53
ISHP- INDEKSI I SHPUTËS, ISPN- INDEKSI I SIPËRFAQË SË PËRGJITHSHME, ISHN- INDEKSI I SHFRYTËZIMIT TË NËNTOKËS, ISGJ- INDEKSI I SIPËRFAQËS SË GJELBËR							

FORMAT E IMPLEMENTIMIT TË BLOQEVE NË TË CILAT PËRMBAJTET PRIVATE JANË PARAPARË NE TOKË PUBLIKE.

Bloku B4 – pjesa lindore e bllokut



Fig. 23. Pjesa lindore e bllokut C4 a) gjendja eksistuese; b) sipas PRRU-së së vjetër; c) sipas planit të reviduar.

Sipas kalkulimeve nga sipërfaqja e gjithmbarshme e parcelës (2410.63 m²), 2255.83 m² janë pronë publike ndërsa 154.86 janë pronë private.

Më poshtë janë të prezentuara llogaritë më detaje lidhur me ndërtueshmërinë:

LLOGARITJET SIPAS PLANIT TE VJETER								
	a	b	c	d	e	f	g	h
PRONËSIA	SIP. E PARCELES /m ² C4	ISHP	ISPN	ISHN	ISGJ	ETAZHITETI (P+5)	SIP. E SHPUTES SIP E AFARIZMIT	SIP. E ZHVILLUAR MBI TOKE
							a x b	a x c
PRIVATE	154.86	0.6	2.8	0.6	0.4	8	92.916	433.608
						SIPAS PLANIT TE VJETER		433.61
LLOGARITJET SIPAS PLANIT TE RI								
PARCELA E PARAPARE PER BANIM TE LARTË ME KOEFICIENT 1.8								
PRONËSIA	SIP. E PARCELES /m ² 2410.69	ISHP	ISPN	ISHN	ISGJ	ETAZHITETI (P+8)	SIP. E SHPUTES SIP E AFARIZMIT	SIP. E ZHVILLUAR
							a x b	a x c
PRIVATE	154.86	0.3	1.8	0.6	0.4	6	46.458	278.748
PUBLIKE	2255.83	0.3	1.8	0.6	0.4	6	676.749	4060.494
						SIPAS PLANIT TE RI		4339.242
ISHP- INDEKSI I SHPUTËS, ISPN- INDEKSI I SIPËRFAQE SË PËRGJITHSHME, ISHN- INDEKSI I SHFRYTËZIMIT TË NËNTOKËS, ISGJ- INDEKSI I SIPËRFAQES SË GJELBËR								

TRANSFERIMI I TË DREJTAVE TË NDËRTIMIT

Duke qenë se është e pamundur të ndërtohen të gjitha parcelat kadastrale brenda kufirit urban të qytetit, pa e pasur parasysh dislokimin e tyre në hapësira urbane, e duke qenë se në ligjet tona në fuqi është e paraparë që një kuotë e caktuar e sipërfaqeve – në bazë standardeve urbanistike – duhet të destinohen për shërbime publike, me anë të këtij plani mund të parashihen mundësitë e transferit të të drejtave të ndërtimit nga një vend në tjetrin në mënyrë që të lirohet sa më shumë hapësirë për shërbime që janë të lidhura drejtëpërdrejtë me interesin publik.

Në momentin që bëhet transferi i drejtave të ndërtimit nga një parcel në tjetrën, pronësia e asaj parcele apo pjese të parcelës, të drejtat e ndërtimit të së cilës janë transferuar diku tjetër, do të bartet në pronësi të Komunës. Këmbimit të pronës duhet t'i paraprijë marrëveshja për shpronësim e cila duhet të jetë trepalëshe, ndërmjet Komunës, pronarit të parcelës, të drejtat e të cilit do të barten diku tjetër, dhe pronarit apo investitorit të parcelës, i cili do t'i pranoj shtimin e të drejtave ndërtimore nga një lokacion tjetër.






Shtimi i të drejtave ndërtimore, i cili do të ndikojë në shtimin e etazhiteteve të ndërtimit, nuk mund të tejkaloj etazhitetin maksimal të paraparë me PZHU apo të ndonjë plani tjetër të nivelit më të lartë që do të miratohet në të ardhmen.

Kur flitet për transferin e të drejtave ndërtimore, nënkuptohet vetëm transferi i të drejtave sipas Indeksit të sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore, dhe jo Indeksave të tjerë që kanë lidhje me atë parcelë






5.4 PROJEKTET PËR ZHVILLIM

Përveç veprimeve administrative, ndërtimit të politikave dhe strategjive, realizimi i Planit Rregullues Urban "Arbëria 3" ka të bëjë edhe me realizimin e disa projekteve të planifikuara për 10 vitet e ardhshme. Këto projekte paraqesin të gjitha veprimet që duhet ndërmarrë në fushën e planifikimit, projektimit, hulumtimit dhe studimit profesional. Në figurën e mëposhtme janë paraqitur këto veprime të cilat janë ndarë në: projekte të dizjanit urban, projekte të peizazhit, projekte të arkitekturës si dhe projekte që kërkojnë studime dhe hulumtime në nivel më detal.





KONKURSE PËR PROJEKTE TË DIZJANIT URBAN

-  Dizajni urban për hapësirën publike/ zonën e këmbësorëve përgjatë hekurudhës
-  Dizajn urban për hapësirën publike/ zonën e këmbësorëve përgjatë rrugës kryesore "A.Krasniqi"
-  Dizajn urban për rregullimin e hapësirës së lirë dhe të parkingut të ndërtesës së Komunës
-  Ridizajnimi i hapësirave publike në mes të ndërtesave ekzistuese të banimit kolektiv
-  Dizajn urban për kompleksin e shërbimeve publike-zona "Parku"





KONKURSE PËR PROJEKTE TË ARKITEKTURËS


-  Projekti ideor për shkollën fillore SHFMU 1 dhe SHFMU 2
-  Projekti ideor për qerdhe/kopshtet: QK "Qendra", QK "Veranda", QK "Prerija", QK "Fshati", QK "Parku"
-  Projekti ideor për Qendrën e Mjekësisë Familjare
-  Projekti ideor për qendrën e sigurisë: stacionit të policisë dhe zjarrfikësve
-  Projekti ideor për nënkalinimin me përmbajtje aktive "Arbëri-Lakrishte"

KONKURSE PËR PROJEKTE TË PEIZAZHIT

-  Dizjani i peizazhit dhe arkitekturës peizazhore për qendrën e sportit dhe të rekreimit
-  Dizajni i peizazhit për zonën e varrezave ekzistuese
-  Dizajni i peizazhit për zonat e parqeve
-  Dizajni i peizazhit për gjelbërimin izolues përgjatë rrugës kryesore "A.Krasniqi"

PROJEKTE STUDIMI DHE HULUMTIMI

-  Projekte të inçizimit të kushteve teknike të terrenit
-  Studim dhe hulumtim për hekurudhën
-  Studim dhe hulumtim për trenin urban
-  Projekte për pyllëzim të mundshëm- zona në mes të magjistrales dhe varrezave dhe zona e banimit kolektiv



Harta 6 Projektet për zhvillim në lagjen Arbëria 3

6.0 DISPOZITAT LIDHUR ME PËRGJEGJËSITË, BASHKËPUNIMIN DHE PJESËMARRJEN

Vendimmarrja

- Vendimmarrja për zhvillimin e zonës duhet të bëhet nga Asambleja Komunale.

Themelimi i grupit punues

- Grupin punues e themelon kryetari i Komunës dhe duhet të përbëhet prej drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit, drejtorit të Drejtorisë për Financa dhe Pronë, drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim Lokal dhe drejtorit të Drejtorisë për Kadastër. Përveç drejtorëve të drejtorive, në kuadër të grupit punues marrin pjesë edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe përfaqësues të pronarëve të tokës.

Përmirësimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe vetëdijesimi

- Zbatimi i planit rregullues urban për lokacionin do të jetë i suksesshëm vetëm nëse komuna do të fitojë përkrahje të mjaftueshme dhe mirëbesim midis investitorëve dhe pronarëve të saj për këto aktivitete.

Vlerësimi dhe monitorimi

- Plani Rregullues Urban do të vlerësohet në mënyrë të rregullt, një herë në dy vjet përveç nëse ka ndonjë kërkesë të veçantë. Po ashtu zhvillimet aktuale, të dhëna më të kompletuara nga Studimi i Fizibilitetit, Plani i Trafikut, të dhëna në lidhje me nevojat e investitorëve dhe faktorë të tjerë ekonomik duhet të merren në konsideratë.
- Çdo pesë vite plani duhet të rishikohet në tërësi.

Leja ndërtimore

- Procesi i miratimit apo refuzimit të kërkesës për leje, përfshi garancinë për rolet transparente të të gjitha palëve me interes (pronarët, ndërmarrjet, palët tjera me interes dhe administrata) do të përmirësohet përmes qartësimit të procedurave;
- Një bazë adekuate për riparcelim duhet ta asistojnë procesin e lëshimit të lejeve. Ky aktivitet duhet realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë Kadastër;
- Leja ndërtimore mund të lëshohet vetëm pas aprovimit të Planit Rregullues
- Leja ndërtimore mund të lëshohet vetëm pasi të plotësohen kushtet për vendosjen e veprimtarive të caktuara.

Studimi i fizibilitetit

· Studimi i fizibilitetit do të identifikojë nevojat e tregut, nevojat financiare dhe do të propozojë modelin më të mirë për financimin e infrastrukturës së lokacionit. Burimet e mundshme të financimit janë: Buxheti i Komunës së Prishtinës kredi nga institucionet bankare, buxheti i Kosovës, kapitali i ndërmarrjeve private dhe donacione të huaja

Menaxhimi i lagjes

Vendimi për modelin e menaxhimit duhet të mirret varësisht nga kapaciteti dhe nevojat e autoriteteve lokale si dhe nga nevojat e banorëve të lagjes.

Bashkëpunimi me pronarët privat

- Komuna do të arrijë marrëveshje me pronarët privat rreth blerjes së pronave nga Komuna nëse ekziston nevoja;
- Komuna do të arrijë marrëveshje me pronarët privat rreth mundësisë së riparcelimit ;

Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit

- Komuna do të lidhë marrëveshje me ndërmarrjet private rreth stimulimit të investimit (kushte të volitshme për investim), krijimit të partneriteteve publike-private, riparcelimit, shpronësimit dhe kompensimit.

6.1 DISPOZITAT E FUNDIT DHE KALIMTARE

Aprovimi i planit

- Aprovimi i planit bëhet nga Asambleja Komunale e Prishtinës menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit publik;

Vlefshmëria

- Ky plan ka vlefshmëri 5 vite nga data e aprovimit të planit, sipas ligjit në fuqi.

6.2 ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM

Hulumtimet, politikat dhe planet shtesë që duhet të hartohen

- Plani i trafikut
- Studimet e fizibilitetit
- Politikat e tokës ndërtimore—komasacioni dhe riparcelimi
- Plani lokal i veprimit në mjedis

ANEKS

Aneks 1: Rrjeti I ujësjellësit dhe kanalizimit - Detaje




Fig1. Prerja tërthore tipike e kanalit ne rrugë




Fig.3 Pusetë kaskadë




Fig.4 Përforcimi i kanalit






Fig.5 Kalimi i rrugës




1. Ujëmbledhësi
2. Pusetë kontrolluese
3. Drejtimi i rrjedhjes sipërfaqësore

Fig.7 Skema e shpërndarjes së ujëmbledhësve ne udhëkryq



1. Shkarkimi nga ndertesa
2. Puseta kontrolluese
3. Rrjeti i oborrit
4. Lidhja ne kanalizim
5. Kanali i rruges
6. Ndertesa
7. Vija ndertimore

Fig.8 Skema e rrjetit të kanalizimit të oborrit



1. Puseta e fundit
2. Kolektori
3. Kurora e kapërderdhjes
4. Kanali përcjellës
5. Shkarkimi në lumë
6. Lumi

Fig.9 Detali I shkarkimit të ujerave atmosferike ne lumë




Fig.10 Hidranti nëntokësor




Fig.11 Lidhja tipike për shtëpi

Aneks 2: Rrjeti primar I ngrohjes qendrore - Detaje

Fig.1. Detali I kanalit, kanali në kthesa dhe detali i saldimit




Fig.2. Detalet e përgjithshme e montimit te gypave ne puseta.




Fig.3. Detalet e përgjithshme e montimit te gypave ne puseta.





Fig.4. Detalet e përgjithshme e montimit te gypave ne puseta.

Gypi I paraizoluar




Izolimi

I

klases

1

DN	d . s (mm)	D (mm)	L (m)	Weight (kg/m)	Insulation thickness (mm)	Water volume (l/m)
20	26,9 . 2,6	90	6	2,9	29	0,39
25	33,7 . 2,6	90	6	3,2	25	0,64
32	42,4 . 2,6	110	6, 12	4,2	31	1,09
40	48,3 . 2,6	110	6, 12	4,5	28	1,46
50	60,3 . 2,9	125	6, 12	6,0	29	2,33
65	76,1 . 2,9	140	6, 12	7,3	29	3,88
80	88,9 . 3,2	160	6, 12	9,3	33	5,35
100	114,3 . 3,6	200	6, 12, 16	13,4	40	9,01
125	139,7 . 3,6	225	6, 12, 16	16,3	39	13,79
150	168,3 . 4,0	250	6, 12, 16	21,1	37	20,18
200	219,1 . 4,5	315	6, 12, 16	30,9	43	34,67
250	273,0 . 5,0	400	6, 12, 16	44,0	57	54,30
300	323,9 . 5,6	450	6, 12, 16	57,0	56	76,80
350	355,6 . 5,6	500	6, 12, 16	63,8	64	93,20
400	406,4 . 6,3	560	6, 12, 16	81,2	68	121,80
450	457,0 . 6,3	560	6, 12, 16	86,0	43	155,10
500	508,0 . 6,3	630	6, 12, 16	97,2	51	192,80
600	610,0 . 8,0	710	6, 12, 16	142,1	39	276,70
700	711,0 . 8,0	800	6, 12, 16	164,1	32	377,60




Izolimi

I

klases


2



Izolimi I klases 3

DN	d . s (mm)	D (mm)	L (m)	Weight (kg/m)	Insulation thickness (mm)	Water volume (l/m)
20	26,9 . 2,6	125	6	3,9	46	0,39
25	33,7 . 2,6	125	6, 12	4,2	43	0,64
32	42,4 . 2,6	140	6, 12	5,1	46	1,09
40	48,3 . 2,6	140	6, 12	5,4	43	1,46
50	60,3 . 2,9	160	6, 12	7,1	48	2,33
65	76,1 . 2,9	180	6, 12	8,7	49	3,88
80	88,9 . 3,2	200	6, 12	10,8	52	5,35
100	114,3 . 3,6	250	6, 12, 16	15,7	64	9,01
125	139,7 . 3,6	280	6, 12, 16	19,1	66	13,79
150	168,3 . 4,0	315	6, 12, 16	24,6	68	20,18
200	219,1 . 4,5	400	6, 12, 16	36,6	84	34,67
250	273,0 . 5,0	500	6, 12, 16	52,2	106	54,30
300	323,9 . 5,6	560	6, 12, 16	66,9	109	76,80
350	355,6 . 5,6	630	6, 12, 16	76,8	127	93,20
400	406,4 . 6,3	670	6, 12, 16	92,9	121	121,80
450	457,0 . 6,3	710	6, 12, 16	101,8	115	155,10
500	508,0 . 6,3	800	6, 12, 16	117,2	133	192,80
600	610,0 . 8,0	900	6, 12, 16	166,9	132	276,74

Gypat e lakuar



Pjesa e drejte dhe gjatesia e lakimit:

DN 25 - DN 125: L = 1m DN 150 - DN 500: L = 1,5m


Gypat e lakuar janë prodhuar nga makina në bazë të një urdhëri, ku është e nevojshme për të përcaktuar kënd lakimi dhe rreze kthese R. Këndi i matur në boshtin qendror të gërmimit është vendimtar për përcaktimin e kënd nevojshme për te lakuar. Vlerat deklaruar janë të destinuar për gjatësisë e gypit 12 m.

α Angula r deviati on in degree s	R Design ed Radius [m]	α Angula r deviati on in degree s	R Design ed Radius [m]	α Angula r deviati on in degree s	R Design ed Radius [m]
1 690		15 46		29 24	
2 345		16 43		30 23	
3 230		17 40		31 22	
4 170		18 38		32 22	
5 140		19 36		33 21	
6 115		20 34		34 20	
7 98		21 33		35 19	
8 86		22 31			



9 76	23 30	
10 69	24 29	
11 62	25 28	
12 57	26 27	
13 53	27 26	
14 49	28 25	

Kthesat 45° dhe 90°




Kthesat e salduara -DN 20 - DN 100: R = 3 D
 DN 125 - DN 600: R = 1,5 D (R = 2,5 D)*


kthese e perkulur -DN 25 - DN 500: R = 2,5 D

DN	Elbow welded		Elbow bended	
	L (mm)	R (mm)	L (mm)	R(mm)
20	-	-	1000	83
25	-	-	1000	110
32	-	-	1000	143
40	-	-	1000	157
50	-	-	1000	180
65	-	-	1000	232
80	-	-	1000	274
100	-	-	1000	340
125	1000	190	1000	330
150	1000	229	1000	390
200	1000	305	1000	510
250	1000	381	1300	650
300	1000	457	1500	775
350	1000	533	1500	850
400	1000	610	1500	970
450	1000	686	-	-
500	1200	762	1600	1245
600	1300	914	-	-

Code: WTS (insulation class) E (dimension) (angle)
 e.g.: WTS 1 E DN 40 45°


Kthesat per çasje ne hyrje te shtepi





Gjatesi deri 1500 mm


Gjatesi deri 2500 mm



Te – Lidheshet me nivel

$$H_1 = (D_1 + D_2) / 2 + H$$

H = 35 mm – distance ne mes te gypave



Reduktuesit

Reduktuesit e parafabrikuar D1

L=1000

mm



